



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 31 korrik 2018, në mbledhjen e IX (nëntë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç znj.Endritë Murati e cila mungoi dhe një anëtar i cili nuk është zëvendësuar ende nga KQZ)

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, kërkoj 1 minutë heshtje për aktivistin e çështjes kombëtare, Adem Demaqi, tash më i ndjerë.
U mbajt një minutë heshtje.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit konstatoi pjesëmarrjen, dhe shtoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj se e keni marrë të gjithë me kohë, po ashtu në hyrje të kësaj mbledhje ju janë shpërndarë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF e mbajtur një ditë më parë ku sigurisht keni vërejtur se në kuadër të rendit të propozuar të ditës është futur edhe një pikë, përkatësisht;

- **Informata e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për punët dhe aktivitetet e KKSB-së për vitin 2017,**

E cila përfshihet në pikën 8, ndërsa pika, *Të ndryshme*, kalon në pikën 9. Përveç kësaj kam një kërkesë edhe nga Drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për ndryshimin e radhitjes së pikave të rendit të ditës, përkatësisht pikën e 5-të ta zhvendosim në pikën 2, për arsye se sot janë takimet tradicionale me mërgatën që mbahet në Shalë të Bajgorës ku janë të ftuara tri komunat (Podujeva, Mitrovica dhe Vushtrria), andaj kërkoj të deklaroheni (me votim) për këtë çështje dhe pa humbur kohë mund të fillojmë me punë.

Njëzëri u mbështet kërkesa e Drejtoreshës së DKRS-së, që radhitja e pikave të rendit të ditës të ndryshoj, përkatësisht: pika 5 zhvendoset në pikën 2 kurse pikat tjera renditen sipas radhës.

Kryesuesi i Kuvendit, e hedh në votim rendin e propozuar të ditës suke përfshirë pikësh shtesë dhe ndryshimin e renditjes së pikave.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës, me plotësim ndryshimin si vijon:

- Në pikën 8 përfshihet pika, Informata e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për punët dhe aktivitetet e KKSB-së për vitin 2017, kurse në pikën 9 kalon pika, Të ndryshme.

- Pika 5 e paraparë në kuadër të rendit të propozuar të ditës kalon në pikën 2, kurse pikat tjera renditen sipas radhës.

1. Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës të mbajtur më 29 qershor 2018

Njëzëri u miratua pa vërejtje

2. Propozimi i vendimit për mbështetje financiare Teatrin Publik të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë

znj.Donika Sfishta, Drejtoresh e DKRS-së, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, Teatri aktualisht ka tri nivele të organizimit të punës, skena për të rritur, skena për fëmijë dhe skena për të rinjtë. Në skenën për fëmijë është i organizuar kursi ku aktualisht janë duke u angazhuar rreth 60 fëmijë të moshës 5 deri në 14 vjeç, niveli i parë i kursit të aktrimit ka përfunduar dhe është shfaqur Shfaqja "Aventurat e Fëmijëve" dhe aktualisht është duke punuar për realizimin e një shfaqjeje "Teatri dhe ne" që do të prezantohet në festivalin "Teatri Ndryshe". Në skenën për të rinjtë është realizuar shfaqja e Dramës "Fausti" ku janë përfshirë rreth 20 të rinj të shkollave të mesme e që në këtë vit do të shfaqet edhe pjesa e dytë e kësaj Drame. Pra vëmendje e jashtëzakonshme do t'iu kushtohet fëmijëve dhe të rinjve, aktivizimit të tyre dhe krijimit të kushteve për talent/e të ri/reja. Në skenën për të rritur janë realizuar dy premiera, Komedia "Tag" ku janë angazhuar mbi 20 persona dhe ka marrë pjesë në festivalin e Komedisë në Gjakovë, dhe është realizuar Drama "Kosovatrans" me të cilën Teatri është prezantuar në festivalin "Talia e Flakës" në Gjilan dhe ka marrë çmimet, Aktori më mirë, Skenografia më e mirë dhe çmimin për tekstin më të realizuar, dhe po ashtu Teatri me këtë shfaqje – Dramë është prezantuar edhe në festivalin ballkanik në Bursa të Turqisë.

Teatri publik i qytetit "Avdush Hasani" është organizator i festivalit "Teatri Ndryshe" ku shfaqen festivale të zhanreve të ndryshme. Skena për të rritur do të realizoj tri shfaqje, Dramën "Tenda" – pjesa e dytë, Dramën "Krimi dhe dënimi" dhe Komedinë "Aa ato ditë të bukura". Gjithherë Teatri duhet të funksionalizohet dhe duhet të fuqizohet si Institucion shumë i rëndësishëm kulturorë, dhe për të ndodh një gjë e tillë po ndërmerren dhe duhet të ndërmerren disa veprime ku aktualisht janë duke u bërë disa renovime në sallën e Teatrit. Jemi të vetëdijshëm se Teatrit i nevojitet më shumë mjetet materiale për realizimin e planit të punës, mirëpo aktualisht këto janë mundësitë e DKRS-së. Shpresojmë se zgjidhja e përhershme e buxhetit për Teatrot, do të rregullohet me ndryshim plotësimin e Ligjit për Teatrot që është në procedurë dhe që sponsorizohet nga MKRS dhe harmonizimi i tyre me Ministrinë tjera përkatëse në mënyrë që Ligji i cekur të jetë më shumë funksional, andaj bazuar në planin e punës dhe kërkesën e Teatrit, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës të miratoj shumën prej 12,500.00 € në mënyrë që t'ia mundësojmë Teatrit realizimin e programit

sipas planit të punës për vitin 2018. Nga kjo shumë, një pjesë e mjeteve janë për organizimin e festivalit “Teatri Ndryshe” e që në këtë vit është edicioni i 10 jubilar.

z.Avni Fetahu, theksoi, sigurisht që ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së i përkrahim këto aktivitete duke shpresuar që edhe njoftimi varësisht formave të aplikueshme të bëhet në masë më të madhe në mënyrë që pjesëmarrja e qytetarëve të jetë sa më e madhe dhe të aktivitetet e Teatrit të Qytetit të përcillen sa më shumë që të jetë e mundur.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, për fushën e kulturës vërehet një shpërqendrim i vëmendjes i faktorit vendimmarrës duke lënë pas dore për një kohë të gjatë, duke injoruar në shumicën e segmenteve të saj. Komuna ka bërë fare pak për afirmimin e vlerave kulturore autoktone të kësaj treve në kultivimin e vlerave ekzistuese dhe mentalitetit për kulturën, në krijimin e mundësive për zhvillimin e talentëve, iniciativave dhe konsolidimin e kapaciteteve ekzistuese kulturore. Teatri duhet të insistoj në përfitimin e publikut në mënyrë që të operoj si institucion sipas rregullave të ekonomisë së tregut ku produkti shitet sepse kapitali intelektual ka vlerën e vet. Është mirë që Teatri i Qytetit “Avdush Hasani” ka përfituar trajtim institucional adekuat për të cilin duhet angazhuar që të funksionoj normalisht dhe suksesshëm por pa lënë anash edhe aspektet tjera të kulturës sepse nocioni kulturë është më i gjerë. Në çfarë niveli është përkujdesja për trashëgimin kulturore të kësaj treve, kam përshtypjen se kjo trashëgimi është në shkatërrim e sipër pikërisht për mungesë të interesimit të faktorëve relevant komunal, pastaj biblioteka vepron në kushte jo të mira si në aspektin fizik ashtu edhe në atë përmbajtësor. Arkivi komunal funksionon në kushte jo njerëzore të cilat nuk hasin as në mesjetë ku kushtet e punës aty janë jashtë çdo norme. Ansambli “Josip Reli” dhe Shoqëritë kulturore artistike të pambështetura në zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Krijuesit artistik, shkrimtar, krijues, poet, piktor, skulptor nuk kanë asnjë adresë në drejtim të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sporti në Komunën e tyre. Duke pas parasysh mundësitë buxhetore, kultura është e diskriminuar në çdo ndarje buxhetore dhe është lënë fare pas dore me vite të tëra dhe në secilin aspekt të saj ka dështime. Vëmendja e faktorëve komunal duhet të drejtohet në këtë kahë në kulturë për ta mbështetur atë, zhvilluar, për t’i prezantuar vlerat e kësaj treve që nuk janë të pakta. Parimisht duhet ndihmuar Teatrin sepse kështu ndihmohet kultura, ne kërkojmë mbështetje më të madhe për Teatrin dhe kulturën në përgjithësi, andaj LVV abstenon në këtë mbështetje financiare për Teatrin e Qytetit “Avdush Hasani”.

z.Fatmir Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së në parim e mbështet këtë shumë të mjeteve financiare për Teatrin e Qytetit “Avdush Hasani”, mirëpo mendojmë se informatën të cilën e bëri Drejtoresha e DKRS-së ka mund të na e dërgojë edhe më herët, e që nga e njëjta kam kërkuar informatë edhe për Klubin e Futbollit “Llapi” që katër seanca më parë por që kjo nuk po e sheh të arsyeshme të sjellë një informatë të tillë, andaj sot publikisht bëjë thirrje të sjellët informata në fjalë në seancën e radhës, ose në të kundërtën po na detyroni të mbledhim nënshkrimet dhe të thërrasim seancë të jashtëzakonshme.

z.Fitim Haziri, theksoi, duke ju referuar kërkesës së DKRS-së për mbështetje financiare Teatrin e qytetit “Avdush Hasani”, meqë Teatri është pasqyrë e kulturës të një populli, e kultura është tërësia e rritjes së një fushe dhe prodhimit dhe të zhvillimit shoqëror dhe mendor për përfshirje në krijimtarinë e gjithanshme në gjuhë, art, letërsi, shkencë dhe tërë jetën shoqërore. Pra në bazë të kësaj që kemi parë në këtë kërkesë, nëse e shikojmë në aspektin e kulturës gjuhësore në vetëm dy fjali kemi më shumë se tri gabime drejtshkrimore, në vend të fjalës ndajë, për të ndarë diç shumë parash a mjeteve është shkruar “ndaj” (ndaj meje, ndaj neve, ndaj atyre), pastaj në vend të planifikuara, është shkruar “planikuara”, në vend që të shkruhet bashkangjesim, është shkruar “bashkngjesim”, këto i gjeni në faqen 5, mirëpo përveç kësaj ka gabime në shenjat e pikësimit, në shifra e që kjo Drejtori nuk është dashtë të bënë gabime të tilla. Kërkesa nuk është e formuluar siç

duhet ku sipas saj është kërkuar të ndahen mjete materiale 14,500.00 € të planifikuara për realizimin e dy shfaqjeve teatrore si dhe për organizimin e festivalit “Teatri Ndryshe” e që nuk dihet për cilat shfaqje është planifikuar, kështu që nuk dini të planifikoni. Ju keni paraparë që në këtë vit të rinovohet salla e Teatrit kurse në vitin tjetër të ndërtohet Teatri i ri, kjo është keqpërdorim i parësë së qytetarëve, madje si dini të planifikoni mund të shikoni në faqe 9 ku gjithashtu ka gabime gjuhësore, thuhet, projektet të cilat janë planifikuar të realizohen gjatë vitit 2018 i janë paraqitur Këshillit Drejtues për miratim, ndërsa menjëherë keni paraqitur shfaqjet të cilat i keni planifikuar të realizohen gjatë vitit 2017. Ju jeni ata të cilët artin e keni lënë mbrapa në Komunën tonë dhe është dashur të largoheni nga kjo Komunë. Nga mjetet e planifikuara prej 25,080.00 € nga DKRS është kërkuar të ndihmohet me vlerë 14,500.00 € ndërsa pjesa tjetër kërkohet subvencionim nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit – MKRS, lind pyetja, në rast se MKRS nuk e subvencionon në total diferencën e mbetur si do të mbulohen këto projekte, pastaj përse Komuna nuk e ka aprovuar kërkesën në total prej 14,500.00 € kur bëhet fjalë për një shumë të vogël të mjeteve, por i ka aprovuar vetëm 12,500.00 €, atëherë shtrohet pyetja, cilën nga pjesa e projektit e paraqitur në projektin e Teatrit “Avdush Hasani” do të largohet si rezultat që në dispozicion të realizimit të projektit janë 2000 € më pak, kjo është arsyeja pse ne abstenojmë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, vetëm kur përmendet emri Avdush Hasani, unë kam një nostalgji dhe emocionohem sepse kemi vepruar së bashku në një kohë që ka qenë e vështirë për të bërë kulturë, për të përcjellë mesazh të kulturës te populli në kushte shumë të rënda dhe kur shoh sot se ka përfunduar aktiviteti i këtij Teatri me 12,500.00 €, vërtetë është një injorancë ndaj Kulturës, ndaj atij Teatri kur vetëm Kryetari jonë, që nuk po na vie kurrë, ka porositur darkë 6000 € në një kafe të Prishtinës për mysafirët që i ka pasur këtu, kjo është një injorancë totale, kjo është e tmerrshme sepse po shihet se kultura trajtohet vetëm sa për sy e faqe, kur gjatë okupimit Llapi ka pasur 17 shoqëri artistike dhe sot e ka “Josip Relën” që gjeneratat e kanë mbajtur kulturën përmes saj, edhe ajo injorohet edhe pse shpërblehet me disa mirënjohje. Jo që nuk pajtohem por nëse ndajmë mjete 50 – 100 mijë €, deri tek trashëgimia kulturore që u cek, madje keni bërë fotografi nëpër Kulla të ndryshme nëpër Llap me Ambasadorë të huaj dhe reklamime tjera, kurse sot e asaj dite nuk i keni përfshirë në planifikime, përkundrazi kjo administratë ka shkatërruar monumente kulturore siç është monumenti i luftës antifashiste nacional çlirimtare ku edhe sot nuk e dimë se ku gjenden ato, qoftë edhe si mbeturina, e që ka elemente edhe të veprës penale, jo që abstenojmë por kjo ndarje e buxhetit duhet të kundërshtohet nga të gjithë sepse kultura është bazë prandaj unë jam kundër shumës 12,500.00 € ngase paraqet injorancë për kulturën kur e dimë se ky popull ka kapacitete për të bërë kulturë dhe për t’i dhënë kulturë shpirtërore këtij populli dhe këtyre qytetarëve, e jo të ndodh ashtu siç e ceku edhe znj.Lirika Maliqi, neve na ikin kuadro sepse këtu nuk kanë pritje, nuk respektohen dhe nuk vlerësohen, prandaj jam kundër këtij propozim vendimi për arsye të shumës së ulët të ndarë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne kemi parë se kërkesa për Kuvendin e Komunës ka qenë për 14,500.00 € nga ana e Teatrit si Institucion të cilin e kemi ngritur ne si Kuvend dhe ju kemi gëzuar mjaft konsolidimit të tij. Nuk dëshiroj të lëshohem në fusha tjera të kulturës sepse gjendjen të gjithë e dimë ashtu siç besoj që edhe vet Drejtohesha e DKRS-së e dinë se si qëndron, mirëpo tani kemi dy solucione, ta mbështesim Teatrin për punët që janë kryer në vitin 2017, nëse nuk gabojmë kemi të bëjmë me ndarje të buxhetit për atë çështje apo si është puna, apo mos ta mbështesim fare. Unë propozoj që për t’i jap mbështetje këtij propozim vendimi nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së, të mbështet në tërësi kërkesa e Teatrit, në shumë 14,500.00 €, pra kemi të bëjmë me një diferencë prej 2000 € të cilat Tetarin e lënë në mëshirë të MKRS-së. Nuk e di arsyen e zvogëlimit të shumës për 2000 € sepse mendoj se ka mund të plotësohen nga të hyrat vetanake, pastaj nuk po kërkojmë shumë më të madhe për Teatrin sepse as ata vet nuk kanë kërkuar por kanë kërkuar 14,500,00 € për të

përmbyshur planin dhe për tu mos u ankuar as në Komunën por as në artistë/e. Kështu që shuma prej 14,500.00 € në bazë të punëve të kryera nga Teatri, Kuvendi i Komunës ta mbështet kërkesën e tyre mandej mbetet çështje e DBF dhe DKRS se ku mund t'i gjen mjetet, përndryshe unë e di që duhet të ndahen shumë më shumë mjetet buxhetore për Teatrin, por nëse nuk mbështesim këtë kërkesë pastaj nuk mund të mendojmë të mbështesim kërkesa nga 50 mijë e 100 mijë €, andaj besoj se duhet të mbështet kjo kërkesë duke besuar se drejtori i DBF do t'i siguroj edhe atë shumë prej 2000 € sepse nga ajo që kam parë në raportin financiar tek të hyrat nga qiraja dhe nga shpenzimi i telefonisë fikse, besoj se edhe 2000 € gjinden për Teatrin, prandaj kërkoj që kërkesa e Tetarit të mbështet në tërësi 14,500.00 €, pastaj të shikojmë për nevojat tjera, madje është paksa e çuditshme përse është kërkuar vetëm kjo shumë sepse nuk di çka do të bënte Teatri tani në vitin 2018, por kjo të mbetet çështje e tyre, por si Institucionin i Komunës nuk është mirë të dalim kundër Teatrit të qytetit sepse në atë ka artistë/e të të gjitha fushave dhe janë bashkëqytetarë tanë, përndryshe për shumën prej 12,500.00 € për Teatrin nuk dalim kundër por do të abstenojmë në formë të metodës së mbështetjes.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, pyetje para folësit, kërkesa juaj paraprake a është në emër të Grupit të këshilltarëve apo personale sepse paraprakisht z.Fatmir Rudari e tha se në parim e mbështesim këtë propozim vendim.

z.Rafet Llapashtica, përgjigje Kryesuesit, kërkesa është në emër të Grupit nga radhët e PDK-së

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, pra kemi të bëjmë me një kërkesë për rritje të shumës për mbështetje Teatrit e qytetit përkatësisht sipas kërkesës së Teatrit, andaj mund të jepen sqarime, dhe përgjigje konkrete nga ana e Ekzekutivit të Komunës.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, theksoi, kërkesa e Teatrit është një prej kërkesave të parashtruara në DKRS dhe jemi munduar të ndajmë buxhet në kuadër të planifikimeve për vitin 2018, mjete këto të cilat janë kërkuar për aktivitete të cilat do të ndodhin në vitin 2018, e jo për vitin 2017 siç u cek sepse për këtë vit në mandatin e kaluar Kuvendi ka miratuar një buxhet prej 9700 € për Tetarin, andaj sot jemi duke diskutuar për buxhetin e vitit 2018 i cili është duke u realizuar. Është e evidente se DKRS ka një buxhet të miratuar prej 60,000.00 € dhe në kuadër të tij ka të ndara shumën 12,500.00 € për Teatrin e Qytetit, dhe duke lënë pjesën tjetër të buxhetit për fusha tjera kulturore dhe sportive dhe shoqëri tjera kulturore që cilave do t'iu ndahen buxhet, në fakt një pjesë të tyre veç iu është ndarë. Andaj është shumë e arsyeshme që këto mjete sipas propozim vendimit të mbështeten dhe të realizohen brenda këtij viti e jo të themi – kërkojmë shumat tjera më të mëdha kurse të mos jemi në gjendje që ato mjete t'i paguajmë pastaj. Këto shuma për subvencione në DKRS janë të planifikuara nga të hyrat vetanake, prandaj unë po insisto që ky buxhet prej 12,500.00 € të miratohet në mënyrë që Teatri i Qytetit të realizoj projektet sipas planifikimeve pa mbet keq për asgjë. Në raportin - planin e Teatrit janë paraqitur disa shpenzime të cilat me mirëkuptim janë zvogëluar dhe është caktuar shuma prej 12,500.00 € për të cilën janë dakorduar DBF, DKRS dhe Teatri që të realizohen planifikimet e bëra për vitin 2018. Asnjëherë nuk jemi pajtuar qoftë pozita qoftë opozita, për shuma të tilla, por kemi rënë në dakord që shumat të jenë shumë më të mëdha në mënyrë që të krijojmë mundësi për aktivitete kulturore gjithnjë e më të mira, mirëpo këto janë mundësitë buxhetore, dhe nuk kemi të bëjmë me atë që u cek, a mund t'i gjemë apo jo, ngase ne përballemi me buxhetin e planifikuar në kuadër të kategorive përkatëse kurse lëvizjet në kuadër të projekteve ose të subvencioneve mund të realizohen vetëm në rastet kur miratohen përmes Kuvendit të Komunës. prandaj edhe njëherë kërkoj që shuma prej 12,500.00 € për mbështetje Teatrit e Qytetit të miratohet në mënyrë që Teatri të mund të realizoj planifikimet. Vlen të theksohet se unë personalisht e përkrah edhe një pjesë të diskutimit të znj.Lirika Maliqi e cila tha se Teatri duhet të mbështetet edhe në ekonominë e tregut dhe për një gjë të tillë jam shumë në dakord që produkti i tyre të shitet apo të realizojnë shfaqje të mira dhe të ketë pjesëmarrje të lartë të publikut dhe si rrjedhojë të inkasojnë ë

hyra vetanake vetë Teatri që do të ishte një pjesë e mirë e buxhetit që do të realizohej edhe nga vet Teatri, që do të ishte buxhet shtesë përveç buxhetit të ndarë nga Komuna dhe eventualisht nga MKRS-së.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pasi që nuk ka të lajmëruar për diskutim, unë e hedh në votim kërkesën e Drejtorisë për mbështetje financiare sipas propozim vendimit përkatës.

Pas votimit 17 vota ishin për kërkesën e DKRS-së përkatësisht sipas propozim vendimit përkatës, kurse 15 vota ishin për propozimin për ngritjen e shumës për mbështetje Teatrin e qytetit.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se miratohet propozim vendimi sipas materialit të dërguar.

3. Propozimi i Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës **- Propozimi i vendimi për vënie në diskutim publik**

z.Gëzim Namani, Drejtor i DA, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, kemi dy propozime të Kryetarit të Komunës drejtuar Kuvendit të Komunës, fjala është për propozimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës, e cila për qëllim ka organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetenca vetanake të përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale, dhe e cila parasheh mënyrën e bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane duke formuar Këshillat lokale si trupa mbështetës të organeve të Komunës dhe që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse të cilat promovojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Në funksion të ushtrimit të këtyre kompetencave, Komuna do të mbështesë në zgjedhjen e këtyre Këshillave lokale në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane si dhe kryetarët e Këshillave lokal.

Propozimi tjetër ka të bëjë me vënien në diskutim publik të propozim rregullores në fjalë, diskutim i cili parashihet të zgjatë 30 ditë (03 gusht 2018 deri 03 shtator 2018), kurse debati publik me qytetarë të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës ashtu siç u pajtuam në KPF, më datë 23 gusht 2018 nga ora 10;00. Sa i përket propozimeve, sugjerimeve apo vërejtjeve eventuale, ato mund të paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në zyrën nr. 32 për marrëdhënie me publikun dhe informim, si dhe mund të dërgohen në formë elektronike në adresat e dy zyrtarëve përkatës sipas propozim vendimit përkatës. Diskutimin publik do ta zbatoj Drejtoria e Administratës në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtoritë tjera, Koordinatorin për bashkëpunim me fshatra, vendbanime dhe lagje të qytetit si dhe me zyrën për marrëdhënie me publikun dhe informim.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahë propozim rregullor në fjalë, dokument të cilit natyrisht se i paraprinë qëllimi, fushëveprimi dhe fushat tjera me rëndësi, kurse me theks të veçantë kërkojmë që komisioni për zgjedhjen e Këshillave lokale të respekton kriteret për zgjedhjen e Këshillave lokale duke inkurajuar të marrin pjesë njëres të përgjegjshëm për ushtrimin e detyrave me të cilat angazhohen, si dhe njerëz të cilët duhet të jenë sa më pak të inkuadruar në politikë, ashtu siç parashihet edhe me Rregullore. Lidhur me këtë çështje ne besojmë se ka disa energji dhe potenciale të fjetura në vendbanimet tona dhe në qoftë

se do e zgjedhim një fshat model me një ekip njerëzish që do ta përbënin këshillin lokal duke inkurajuar që të marrin pjesë banorët e asaj ane duke përfshirë fermerë, artistë, dhe njerëz të vullnetit të mirë, do të bënim një model fshati që do ta kishin lakmi edhe fshatrat tjera të Komunës tonë por edhe komuna tjera, dhe nga kjo do të rrjedhin në formë zingjirore edhe shumë projekte dhe donacione nga Institucione të ndryshme, andaj ne do të propozonim të fillojmë me fshatin Orllan i cili karakterizohet me shumë gjëra me rëndësi duke filluar nga aspekti kulturorë, historik, turistik etj. dhe kjo qasje do t'i bënte edhe më atraktive fshatrat dhe banorët në përgjithësi për të jetuar në ato fshatra por edhe duke inkurajuar njerëzit të kthehen në fshatra, investitorët të investojnë dhe një jetë më të shëndetshme për banorët. Drejtoria e Administratës dhe Drejtoritë tjera të cilat ndërlidhen me këtë propozim Rregullore, nëse mendoni që vetëm ta bëni një rregullore sa për të marrë kërkesat e banorëve nga këshillat lokal për kërkesat dhe nevojat e tyre, neve do të na duhet një buxhet i tërë për t'i përmbushur ato kërkesa, por nëse krahas marrjes së kërkesave gjejmë edhe mundësi të financimit të projekteve me interes të banorëve ne do të siguronim një stabilitet financiar tek ata banorë që në mënyrë indirekte nga veprimtaritë bujqësore që do të zhvillojnë do të siguronin taksa për mbulimin e atyre kërkesave të fshatrave përkatëse, gjithnjë duke rikujtuar se tek një fshat nuk përfundon gjithçka me përfundimin e asfaltit por duhet të ketë edhe ndriçim, rrugë për këmbësorë, shtigje për çiklizëm dhe shumë gjëra tjera që e bëjnë fshatin më atraktiv për të jetuar. Si rekomandim për komisionin, të shikohet si storje e suksesit, siç e ka bërë Fishta tek Mrrizi i Zanave në Shqipëri, e që kam dëgjuar se shumë politikan të Kosovës vizitojnë atë vend për dreka e darka por asnjëherë nuk marrin si model dhe ta realizojnë një gjë të tillë në vendin tonë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, Ligji për vetëqeverisje lokale është nxjerrë në vitin 2008 duke përfshirë edhe Udhëzimin Administrativ përkatës i cili ka të bëjë me marrëveshjet e lidhura midis Komunave dhe qytetarëve, dhe në këtë aspekt un kam hulumtuar por nuk kam hasur se ka pas deri më sot Komuna e Podujevës një rregullore të tillë, dhe nga kjo mund të sjellët një konstantit se deri më sot kjo gjë ka shkuar në formë të anarkisë, me shokë dhe militant të partisë dhe janë kryer disa formalitete kinse ligjore, dhe tani më vie mirë që do ta kemi një Rregullore të tillë e cila i plotëson kushte edhe në bazë të ligjit dhe Udhëzimit Administrativ përkatës.

Çështjen që e ceku parafolësi z.Avni Fetahu, e vlerësoj si me plotë të drejtë që ta kemi një fshat nga i cili dëgjohej zëri i banorëve qoftë për kërkesat e tyre qoftë për projekte të reja dhe në këtë aspekt u përmend Mrrizi i Zanave në Fishtë, por ju sigurisht keni parë rrugën Marincë – Bellosicë e cila është e pakalueshme, pastaj rruga për fshatin Repë e cila është prishur dhe të tjera nevoja të cilat janë tepër elementare e që nuk janë plotësuar nga kjo administratë komunale, kurse sa i përket modele fshatrash, mendoj se është mirë të nisemi nga e thjeshta dhe nga nevojat ekstreme të qytetarëve, mirëpo meqë do të ketë debat publik, do të ketë mundësi që qytetarët të japin propozime, sugjerime për plotësim ndryshime të kësaj Rregulloreje. Meqë ne jemi opozitë nuk do t'ju lejojmë të veproni siç keni dashtë dhe siç keni vepruar më parë, këtë sinqerisht jua them, dhe nëse mendoni ta bëni vetëm 'sa për sy e faqe' Këshilla që e dëgjojnë partinë ose Kryetarin e Komunës. Tek çështja e votimit apo e zgjedhjes mendoj se është mirë që përveç zgjedhjes me votim të hapur të jepet mundësia edhe e votimit të fshehtë dhe atë të jepet mundësia që në qoftë se një qytetarë propozon votim të fshehtë dhe nëse mbështetet nga 1/3 e pjesëmarrësve, përse të mos shkohet me votim të fshehtë që është mënyra më demokratike dhe që besoj se edhe ndikimi i partive do të ishte i pamundur apo shumë i vogël. Pastaj çështja tjetër që unë mendoj se duhet të plotësohet dhe ndryshohet, është përcaktimi i një numri minimum pjesëmarrës, qoftë për lagje, fshat apo vendbanim, i cili duhet të jetë prezent për të mund ta zgjedh Këshillin lokal, shembull për fshat të jetë numri i pjesëmarrësve 21, për lagje 31, dhe për vendbanime 51, e jo të kalohet me

7-8 persona bie fjala. Pra edhe pas rreth 20 viteve nga paslufta pjesëmarrja e qytetarëve në debate – organizime të tilla nuk është ashtu siç duhet, andaj duhet të mendojmë ta gjejmë fajtorin, ose nuk na dëshirojnë qytetarët ose nuk vijnë, në këtë rast për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre të fshatit, lagjes apo vendbanimit përkatës. Kështu që besoj se edhe në debat do të marrim pjesë dhe do të paraqesim ndryshimet të cilat janë të nevojshme, por këto dy çështjet që i përmenda janë mjaft të rëndësishme sepse ne duhet të mundohemi dhe të gjejmë forma më demokratike që qytetarët të shprehin lirshëm vullnetin e tyre. Sa i përket ngritjes së komisionit, mendoj se është e përcaktuar mirë që aty duhet të jenë dy anëtarë nga radhët e Kuvendit e që normalisht do të jemi edhe ne, por me rastin e ngritjes së këtij komisioni është mirë të kemi kujdese në mënyrë që të jetë një komision i mirëfilltë i cili duhet ta zbatojë këtë Rregullore.

Rreth materialeve të këtij Kuvendi, është mirë të nënshkruhen dokumentet, shembull Raporti i DBF është i panënshkruar, pastaj nga informata e DKA-së tani e kuptova që kjo Drejtori është me Ushtrues detyre, mandej Nënkryetari i Komunës nënshkruar aktet e Kryetarit e që neni 60 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale e përcakton se Nënkryetari i ndihmon Kryetarit dhe kryen veprime, por në mungesë të tij, ndërsa a është këtu apo jo Kryetari nuk e di sepse siç e keni vërejtur e ka një injorancë ndaj këtij Kuvendi dhe nuk është në gjendje të ballafaqohet as me ne si opozitë por tani së fundmi edhe me ju pozitën, andaj mendoj se aktet dhe dokumentacioni tjetër të sjellën në Kuvend ashtu siç ka përcaktuar ligji. Ne do ta votojmë këtë propozim Rregullore duke përfshirë edhe propozimin për vënie në diskutim publik dhe do të përpiqemi të jemi kontribut dhënës deri në fund përkatësisht deri në realizimin definitiv të saj.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Rregulloja është shumë e nevojshme të funksionalizohet ashtu si duhet. Dëshiroj të ndalem tek paragrafi 1 i nenit 4 ku thuhet, Komisioni duhet të ketë 5 anëtarë, 2 nga Kuvendi i Komunës, 1 anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës, 1 nga Shoqëria Civile dhe 1 anëtar nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, mirëpo ky i fundit nuk di si është paraparë të zgjedhet, nëse nuk ka diçka funksionale dhe nëse është në rregull, atëherë si është paraparë të zgjedhet ai përfaqësues i fshatit, lagjes apo vendbanimit. Nuk jam duke paragjykuar asgjë politike por ashtu thuhet, një përfaqësues i fshatit, lagjes apo vendbanimit, do të thotë ne kemi 77 fshatra, kemi disa fshatra të cilat komisioni nuk do të mund të realizojë këtë Rregullore, shembull në fshatin Muhazob është vetëm një banorë sa jam në dijeni, pastaj unë nuk di ku merret kompetenca që një përfaqësues të përfaqësojë fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane. Unë jam në dijeni se ka vend dhe kohë për plotësim dhe ndryshim të kësaj pike deri në miratimin final, por unë po e them sot këtë çështje dhe është mirë që Drejtori ta evidenton si mundësi për shqyrtim. Pastaj duke pasqyruar defektet e sjelljes në Kuvend të propozimit të anëtarit nga radhët e Shoqërisë civile, unë kërkoj në mënyrë shumë demokratike që procesverbali dhe propozim vendimi i anëtarit të Shoqërisë civile të sillet me dokument në Kuvend, para votimit final. Kështu që mund të duken gjëra të vogla por unë mendoj se të caktohet një anëtar i cili do të përfaqësojë krejt komitetin e fshatrave dhe tri zonave të qytetit, duhet ta dimë se kush është ai, apo të mos jetë fare sepse këto komitete janë në proces zgjedhor, madje në bazë të rregullave do të ishte mirë të jetë aty ku ka qenë shumica të jetë edhe përfaqësuesi i fshatit, qoftë i subjektit politik sepse ka qenë shumicë e besimit, por e dimë edhe qëndrimin dhe vendimin e Kryetarit që e ka bërë personin përkatës që e ka bashkëpunimin direkt me atë, jo Kuvendi e jo as Drejtoria por ai me këndë e ka më mirë, e që nuk është në rregull. I nderuar Kryesues i Kuvendit për çdo vendim që merr Kuvendi përgjegjësinë dhe kompetencat duhet t'i merr Kuvendi, madje unë edhe në mandatin e kaluar kam kërkuar që nëse ndokush sjellë në Kuvend ndonjë dokument që ne ta miratojmë dhe nëse për një gjë të tillë rolin e ka Kuvendi, po ashtu shumicën duhet ta ketë Kuvendi dhe përgjegjësinë duhet ta kemi ne e që unë personalisht e marrë çdo përgjegjësi që më takon si anëtar i Kuvendit, por jo

edhe ato të Ekzekutivit. Kështu që i nderuar Drejtor i Drejtorisë së Administratës tek përfaqësuesi i Shoqërisë civile të ketë vëmendje sepse unë me rastin e ngritjes së komisionit do ta kërkoj datën e takimit të të gjitha Organizatave të shoqërisë Civile dhe propozimin e vendimit, e them këtë sepse të gjithë jemi në dijeni se si ka shkuar në dy rastet e kaluara për dy trupa të ngjashme. Pastaj edhe tek përfaqësuesi i fshatrave dhe qytetit me rastin e miratimit të kësaj Rregulloreje fshatrat, vendbanimet dhe lagjet e qytetit hyjnë në proces zgjedhor, andaj në përbërjen e komisionit anëtarë përfaqësues i fshatrave dhe lagjeve urbane duhet të hiqet për arsye se mund të ndodh që i njëjti do të hyjë vetë në proces zgjedhor e që është edhe propozim i imi, sepse komisioni përkatës mbikëqyrë zbatimin e rregullores sipas asaj që Kuvendi ka miratuar, andaj edhe propozova që ai anëtarë të hiqet nga përbërja e komisionit, madje as nuk ka kompetencë të përfaqësoi të gjithë. Çështje tjetër se nuk më duket që mund të jetë shumë funksionale ndarja në tri degë qytetin e Podujevës që parashihet të bëhen tri Këshilla me nga 5-7 anëtarë, propozoj që numri i këshillave lokale në qytet të rritet sepse dendësia, nevojat dhe kërkesat e qytetarëve nuk do të mund të përfaqësojnë të gjithë qytetin. Pastaj në propozim rregullore është paraparë edhe çështja financiare dhe në këtë kontekst më bëri përshtypje çështja ku iu jep të drejtë Këshillave të kërkojnë dhe të mbledhin mjete nëpër komunitet, po ashtu e kam vërejtur edhe mundësinë e kompensimit të kryetarëve dhe anëtarëve të Këshillave lokale që do të përcaktohet me një vendim të veçantë të Kuvendit, andaj ajo që e ceka rreth mbledhjes së mjeteve tek qytetarët si në kohën e solidaritetit, tani në vitin 2018 ky nocion nuk do të dëshiroja të jetë askund sepse për ata jemi Institucion dhe duhet që 100% planifikimet tona të dalin në zero si dhe inkasimet vetanake, pastaj të shfrytëzohet buxheti 100% i investimeve kapitale. Kështu që disa prej pikave që unë i ceka para debatit publik rreth këtij dokumenti i cili është mirë të miratohet dhe e ka mbështetjen e plotë që kjo rregullore të miratohet dhe funksionohet Këshillat lokale, andaj ne sot i japim mbështetjen që kjo rregullore të kalojë në procedurat tjera të parapara por finalizimin final do ta shqyrtojmë dhe diskutojmë edhe njëherë, por mendoj se edhe gjatë debatit publik dhe gjatë takimeve që mund t'i ketë Drejtori i DA-së do të evidentoj edhe çështje tjera të rëndësishme rreth këtij dokumenti.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë mendoj se me këto debate dhe me diskutimin dhe debatin publik që do të zhvillohet por edhe me shqyrtim final të kësaj rregulloreje besoj se do ta miratojmë një Rregullore e cila do t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kriteret sepse është e mirëpritur nga të gjithë dhe e domosdoshme për të gjithë, andaj e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores përkatëse për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës, duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e KPF-së mbajtur një ditë më parë.

4. Raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – qershor 2018

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth shpenzimeve dhe të hyrave të realizuara në periudhën janar – qershor 2018 duke cekë kategoritë ekonomike dhe burimet e financimit si dhe duke bërë një krahasim me përqindje me përuarjen e njëjtë të vitit paraprak, duke shtuar se ky raport është një obligim ligjor i cili ka për qëllim prezantimin e një pasqyre të aktiviteteve financiare për periudhën përkatëse. Në vazhdim drejtori lexon shumatat e shpenzimeve në kategori dhe programe të caktuar sipas planifikimeve për periudhën në fjalë duke krahasuar edhe me shumatat

e shpenzuara në periudhën e njëjtë të vitit 2017. Gjithashtu Drejtori ceku edhe realizimin e të hyrave vetanake duke lexuar shumat e inkasimit sipas tabelës së të hyrave në materialin e raportit duke cekur edhe garantin e performancës së Komunës dhuruar nga Qeveria e Zvicrës, dhe duke potencuar se mbetet shumë për të bërë në periudhën vijuese dhe përkushtim i të gjithëve në mënyrë që realizimi i investimeve kapitale dhe inkasimi i të hyrave të realizohet me sukses sipas planifikimeve të Komunës. Për fund drejtori theksoi, mund të konstatojmë që ky raport financiar jep një pasqyrë të qartë të të hyrave dhe të dalave për periudhën raportuese.

z.Adnan Zymeri, theksoi, me vlerësimin e pasqyrës dhe aktiviteteve financiare të Komunës së Podujevës jemi munduar të identifikojmë pikat në të cilat Komuna ka shënuar progres në kuptimin e zvogëlimit të shpenzimeve dhe zërave tjerë financiar në të cilët duhet të intensifikoj punën dhe të ketë progres me aktivitetin e saj në përgjithësi. Shuma e Inkasimit të të hyrave vetanake që paraqet njërin prej të hyrave kryesore të arkëtimit të buxhetit komunal është rreth 730,000.00 € e që tregon trend efikas të inkasimit në raport me periudhën e njëjtë raportuese të vitit të kaluar, mirëpo edhe përkundër kësaj angazhimit e Komunës duhet të shtohen në funksion të inkasimit më të lartë të burimeve tjera, shembull, lejet ndërtimore, licencat komerciale etj, ku realisht jemi në nivele të ulëta të inkasimeve nga këto burime. Në kuadër të progresit të shpenzimeve vihet re një racionalitet i Komunës së Podujevës në kodin e shpenzimeve të telefonisë mobile, drekave zyrtare etj, ku shihet një raport i zvogëlimit të shpenzimeve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Meqë aktualisht jemi në gjashtëmujorin e dytë të vitit dhe që supozohet se kushtet klimatike do të jenë më të përshtatshme për punë mendoj se Komuna e Podujevës duhet të rritë intenzitetin e punëve që do të ndikonte në përmbushjen e planit të shpenzimeve dhe për investime kapitale, e them këtë për shkak se aktualisht shpenzimet kapitale janë të ulëta andaj konsideroj se me rritjen e intenzitetit të punëve do të arrinim më lehtë përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planifikimet e mëhershme. Prandaj në bazë të vlerësimit të paraqitur së bashku me obligimet që mbeten për tu përmbushur, ftoj ta votoni këtë raport.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ky raport i paraqitur nga DBF është një tregues i kualitetit të kësaj qeverisje në vitin e parë të këtij mandati. Ne si LVV ashtu sikurse edhe në raportet tjera financiare e kemi të njëjtën vërejtje sepse raporti nuk përmbush kriterin e transparencës së shpenzimeve të parasë publike, nuk është i qartë për publikun e gjerë si dhe në disa kode nuk ka raportim të shpenzimeve e që nuk është e logjikshme të mos jenë bërë. Ky raport i buxhetit edhe përkundër mangësive, prap e tregon një të vërtetë të madhe për këtë qeverisje dhe dështimin e kësaj qeverisje si në aspektin e mbledhjes së të hyrave ashtu edhe në aspektin e realizimit të planifikimeve për vitin 2018. Të hyrat në shumicën e pozicioneve janë shumë të pakta madje edhe më pak se në vitin 2017 gjë që është një tregues tmerrësisht i keq kur sheh kthim mbrapa dhe kur dihet një nivel i tillë i buxhetit kjo bëhet dramatike. Tek pozicioni certifikata dhe dokumente zyrtare ka 43% më pak të hyra se në vitin 2018, tek pozicioni lejet dhe ndërtesat ka rreth 44.27% më pak të hyra se në vitin 2018, tek pozicioni të hyrat nga qiraja dhe shfrytëzimi i pronës publike ka 46% më pa se në vitin 2018. Në aspektin e shpenzimeve buxhetore Komuna ka pas efikasitet kryesisht në disa kode ku është dashur të jetë më e kujdesshme në shpenzime ndërsa ka realizim minimal në çdo nivel tek investimet kapitale që janë në dobi të zhvillimit komunal. Shpenzimet e ujit janë rritur 62%, në krahasim me vitin 2017 e që sinqerisht është e çuditshme dhe që ne e konsiderojmë abuzim me ujin e pijes dhe njëkohësisht keq menaxhim të parasë publike, pastaj shpenzimet për mbeturina janë rritur 36.74% në krahasim me vitin 2017, shtrohet pyetja kah ka ardhur kjo rritje ku dihet se nuk ka ndërtesa apo institucione publike tjera, mandej shpenzimet telefonike janë rritur për 148% në krahasim me vitin 2017, furnizimet për zyrë janë rritur për 221.78% në krahasim me vitin 2017, shpenzimet për naftë për ngrohje qendrore janë rritur për 32% në krahasim me vitin 2018, shtrohet

pyetja, nga gjithë ky shpenzim për numrin e njëjtë të institucioneve publike, pastaj shpenzimet për dru janë rritur për 326% në krahasim me vitin 2017, shpenzimet për vendime të Gjykatave në shumë prej 278,880.78 € do të thotë se është mungesë e përgjegjësisë ligjore e udhëheqjes komunale e cila shkakton dëme buxhetit të Komunës. Të gjitha këto rritje të shpenzimeve, në raport me vitin 2017, janë rritur në pozicione buxhetore ku nuk është dashur të ketë rritje. Tek investimet kapitale nga 6,489,514.00 € të planifikuara për investime në projekte të ndryshme kapitale, janë shpenzuar vetëm 614,636.84, € që do të thotë 9.47% e mjeteve të planifikuara. Ky realizim jashtëzakonisht i ulët i investimeve kapitale tregon dështimin e vërtetë të LDK-së në qeverisje që nuk është e re jashtëzakonisht për këtë subjekt. Përkundër buxhetit të ulët për investime kapitale dhe në anën tjetër nevojave shumë të mëdha me vetëm 9.47% të realizimit të buxhetit të planifikuara për investime kapitale, kjo vetëm qeverisje nuk mund të quhet, dhe me këtë trend të investimeve vështirë që do të arrihet shifra 25%. Pra ne Grupi i LVV-së jemi kundër këtij raporti financiar dhe kundër shpenzimeve të parasë publike pasi që në shumicën e rasteve sikurse në mandatin e kaluar kur ne po ngritim ndonjë çështje në të mirë të qytetarëve zakonisht përgjigja nga ana juaj po është se nuk kemi buxhet për ta realizuar këtë çështje, atëherë shpenzimet nëpër kode të ndryshme ekonomike sa vinë e shtohen vit pas viti.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, raportet periodike financiare po sjellën me rregull dhe nga DBF po prezantohen në formë tabelore shpenzimet e realizuara. Kolegu nga LDK e tha që Komuna ka reduktuar shpenzimet por unë duke e shikuar dokumentin pash që është reduktuar puna duke u bazuar në planin e miratuar për projekte prioritare dhe jam dëshmitar i asaj që deri në majin gusht ka pas diçka të planifikuar qoftë nga Drejtoritë qoftë ato të miratuar nga Kuvendi, dua të them se janë votuar projektet ku disa prej tyre deri në muajin gusht është dashtë të kryhen. Gjithashtu në bazë të raportit shoh se kanë qenë disa shpenzime të panevojshme gjë kjo e cila është shumë më e rëndësishme. Nga 6,489,514.00 € për shpenzime kapitale, janë kryer punë në vlerë vetëm 600,000.00 € apo më pak se 10%, kurse çka do të ndodh në muajin shtator është hipotetike sepse ne po diskutojmë për periudhën janar – qershor 2018 dhe nuk mund të paragjykojmë se çka do të kryhet në të ardhmen, dua të them se për 6 muaj të kryhen vetëm këto punë, vet dokumenti tregon se çka është punuar. Pastaj nëse nuk ka pasë metodë të shpenzimit të paktën 50% të buxhetit është shumë hipotetike që deri në dhjetorë të shpenzohet mbi 90% e buxhetit, ndoshta mund të shpenzohet por jo ashtu me planifikim të mirë, nëse jo mjetet mbeten suficid. Pa dashur të flasë në aspektin politik, por shumë në mënyrë kolegiale e them se inkasimi i të hyrave vetanake nuk është në nivelin e duhur, për këtë bazohem edhe në njoftimet e komisionit për dhënien e pronave të paluajtshme të komunës në shfrytëzim, por edhe sa herë ka dal në foltore Drejtori i DBF z.Isuf Latifi për një gjë të tillë sepse jemi në dijeni se inkasimi i mjeteve vetanake në arkën zyrtare të Komunës bëhet vetëm nga të hyrat zyrtare që mblidhen nga performanca, organizimi dhe nga puna e Ekzekutivit të Komunës, andaj përtej këtyre rrugëve zyrtare nuk çka të merr, jep ose shpenzon më shumë as më pak, mirëpo e vetmja fjalë ka qenë tatimi në pronë dhe duke u bazuar në këtë të gjithë qytetarët e shtresës së mesme ose të ulët të cilët janë të sanksionuar për kryerjen e një pune po janë shumë serioz ndaj këtij Institucioni dhe po i përgjigjen pagesës së tatimit në pronë pavarësisht kushteve dhe mundësive të veta, ndërsa unë jam shumë i bindur që zyrtarët e lartë qoftë nga Ekzekutivi qoftë nga Kuvendi i kanë obligimet e papaguara dhe nëse do të mundim që nga këtu të marrim vendim që Kryetari i Komunës t'i shikoj borxhet e zyrtarëve të tij, do të ishte gjë e mirë, pastaj të kërkohet nga qytetarët. Të inkasoj Drejtoria e Inspeksionit vetëm 20,000.00 € nga shfrytëzimi i pronës, nëse komisioni përkatës dhe Ekzekutivi kanë nënshkruar kontratat përkatëse, është shumë e vogël e inkasimit, pastaj në anën tjetër ne ngecëm për 2000 € shtesë për mbështetje

Teatrin e Qytetit, andaj po të jetë një njeri serioz, vendimmarrës dhe i paluhatshtëm do ta mbështet Teatrin me 20,000.00 € apo çdo kërkesë në interesin e përgjithshëm.

Tek shpenzimet e panevojshme, darka dhe dreka, akomodime, mëditje të gjithë jemi në dijeni se gjëra të tilla rregullohen me legjislacion, siç jemi në dijeni edhe për çmimin e një akomodimi në shtetet Europiane, por edhe akomodimet duhet të jenë në parametra të buxhetit, mirëpo kemi të bëjmë edhe me sjelljen e investitorëve sepse kur kemi të bëjmë me kaq shumë udhëtime jashtë vendit dhe shpenzime të drekave edhe investitorët e huaj - investimet nga jashtë nuk guxojnë të mungojnë, përjashtuar atë Gjerman, ne edhe kur ka qenë pyetje a të mbështetet Agim Veliu apo Lutfi Haziri për përfaqësim të Komunave në Bruksel, i kemi dhënë prioritet Komunës tonë edhe pse si opozitë, por nuk mund as ta injorojmë ardhjen e donatorëve me vullnet të tyre dhe kërkesën për marrje të mitos, gjë të cilën nuk mund ta kapërcejmë kushdo qoftë ai sepse duhet të hiqen nga idologjia ose të hiqet dorë nga politika, plus i njëjti drejtor është emëruar në Drejtorinë e Inspeksionit. Unë do të dëshiroja shumë të jetë gjithçka në rregull sa i përket shpenzimeve dhe inkasimit të të hyrave si dhe të jenë në rregull dhe funksionale të gjitha Drejtoritë, e them këtë sepse jemi në muajin gusht dhe ende nuk është emëruar Drejtori i Drejtorisë së Arsimit por qëndron me UD e që duke qenë në dijeni se UD mund të ushtroj vetëm gjysmën e kompetencave, sa do që kam kritika për arsimin më cungohet edhe dhënie e kritikave direkte, kështu që çfarë emërimesh ka bërë Kryetari i Komunës, nganjëherë po them shumë më mirë paska qenë qeverisja e kaluar. Duke marrë si shembull një Ministër Gjerman i cili dha dorëheqje për arsye shumë të vogël e që paga e tij ishte rreth 24,000.00 €, sugjeroj Drejtorët ta ndjekin atë sepse për një pagë sa është rreth 400-500 € të japin dorëheqje, unë do ta bëja sepse nuk do të dëshiroja një ndikim të tillë. Asnjëherë nuk kam zhvilluar debat me Drejtorin e DBF rreth shpenzimeve dhe të hyrave sepse kjo Drejtori vetëm pasqyron ato në raport. Prandaj nuk e mbështes këtë formë të shpenzimeve, nuk e mbështes 10% shpenzim për gjashtë muaj, nuk e mbështesë qeverisjen e cunguar, nuk i mbështesë shpenzimet për akomodime ashtë vendit afër 10,000.00 € pa sjelljen e asnjë donatori, ndërsa në anën tjetër janë disa punë që janë kryer dhe që i mbështes por që janë në numër shumë të vogël.

z.Agron Hyseni, theksoi, edhe unë do ti paraqes disa vërejtje lidhur me shpenzimin e buxhetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018. Dihet se buxheti i Komunave në Kosovë është shumë herë më i vogël se sa nevojat reale në të gjithë sektorët, projektet infrastrukturore, sociale, planet zhvillimore, zhvillimi i bujqësisë të cilat rangojnë si prioritete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata janë shumë më të mëdha kur flasim për nevoja reale, por që buxheti i limituar i kufizon këto projekte, planet zhvillimore, zhvillimi i bujqësisë etj, kurse ajo që bie në sy është se përkundër këtij buxheti të limituar, shfrytëzimi i tij është bërë më pak se 10% dhe kjo është për të shqetësuar, kurse planifikimi i të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës është shumë më i vogël se sa ato të Komunave me ngjashmëri gjeografike, demografike dhe paraqet diku rreth 30% të planifikimit të tyre, por dhe përkundër këtij fakti realizimi i tyre është më pak se 38%.

z.Avni Islami, theksoi, ato që dëgjova deri tani nga pozita dhe opozita po vërehet se ka vërejtje serioze rreth menaxhimit të buxhetit në këtë gjashtëmujor, andaj kërkoj që mekanizmat e kontrollit të buxheti përkatësisht të shpenzimit të tij të punojnë në atë drejtim që shfrytëzimi i buxhetit komunal të bëhet në mënyrë të seleksionuar dhe të mos kemi keq menaxhim.

z.Fitim Haziri, theksoi, një ndër shqetësimet tona rreth raportimit financiar është tek pjesa paga dhe mëditje, kur jemi në dijeni se kjo çështje është e rregulluar në bazë të një sistemi të centralizuar që janë të përfshira Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave, ku kjo Ministri ka paraparë që rreth 13 inspektor komunal dhe 4 zyrtar të kadastrit të paguhen me koeficient 7, kurse ata ende vazhdojnë t'i marrin pagat me koeficient 6, pyes Drejtorin e Drejtorisë përkatëse se çfarë do të bëhet me këta punëtorë kur kemi parasysh që kemi një suficid në shumë rreth

200,000.00 € të cilat i kthehen Ministrisë përkatëse, andaj çfarë keni bërë në këtë drejtim që ata punëtorë të marrin pagat ashtu siç ka paraparë Ministria e Financave.

z.Gëzim Namani, Drejtor i DA, përgjigje parafolësit, theksoi, jo vetëm për inspektorët por për një kategori të punëtorëve të Komunës ku janë 93 të tillë për të cilët kemi bërë kërkesa për ngritje të koeficienteve në Ministrinë e Administratës Publike dhe jemi në pritje të kthimit të përgjigjes, kam korrespondenca me Ministrinë sepse është vija hierarkike e cila duhet të respektohet. Pra kjo ishte vetëm sa për sqarim se është në procedim e sipër çështja e ngritjes së koeficienteve të një numri të punëtorëve të të gjithë sektorëve, ndërsa a lejohet apo jo një gjë e tillë nuk varet prej nesh por sidoqoftë ne kemi bërë detyrat tona dhe vazhdimisht jemi të angazhuar në këtë drejtim, madje vetëm në këtë vit janë dy kërkesa të tilla që janë bërë nga Drejtoria e Administratës, prandaj për çka do që keni interesim mund t'ju prezantoj në zyrë ku unë punoj.

z.Fitim Haziri, theksoi, në bazë të Auditimit kam vërejtur se ky problem qëndron qysh nga viti 2016, ndërsa sapo u njoftuam se tani është bërë kërkesa, andaj përse nuk është bërë më parë.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, sa për sqarim, koeficientët nuk i cakton Ministria e Financave, por tani po mendohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës me ligj të caktohen koeficientët e që mendojmë se së shpejti do të miratohet dhe do të kemi një ligj ku koeficientët për pozita të njëjta do të jenë të harmonizuar. Deri tani një gjë e tillë nuk ka ndodh jo vetëm në Komunën e Podujevës por askund në Kosovë sepse ka laramani të ndryshme të koeficientëve për pozita të njëjta ku për një pozitë të njëjtë ndonjë Komunë ka koeficient të mirë kurse një komunë tjetër ka të vogël, mirëpo Ministria e Financave asnjëherë nuk ka përcaktuar koeficient. Komuna e Podujevës nga viti 2016 për një numër të caktuar të zyrtarëve duke përfshirë edhe pozitat e cekura nga parafolësi, ka planifikuar dhe ka miratuar buxhet në këtë Kuvend, madje edhe në raportin financiar për vitin 2017 e kam cek në formë të sqarimit se prej vitit 2016, 2017 dhe 2018 kemi planifikim të buxhetit për ngritje të koeficientëve për pozitat të ndryshme, duke përfshirë edhe pozitat e cekura nga z.Fitim Haziri, dhe vazhdimisht kemi bërë kërkesa në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Administratës Publike që ta zbatojnë ligjin, e them këtë ngase në momentin kur buxheti i komunës miratohet në Kuvendin e Komunës, dërgohet për miratim në Ministrinë e Financave gjegjësisht në Qeveri dhe i njëjti procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës ku miratohet dhe bëhet Ligj, andaj ligji duhet të zbatohet dhe jemi shumë në dakord, por një gjë e tillë nuk ka ndodh. Në kërkesat tona me shkrim asnjëherë nuk na janë përgjigj në formë të shkruar Ministrinë relevante, me përjashtim kur në një përgjigje të Departamentit të Thesarit është thënë se kjo nuk mund të zbatohet deri sa të miratohet ligji për paga, gjë e cila për mua ka qenë qesharake sepse Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, në këtë rast, duhet të zbatohet, kurse a do të miratohet ligji për pagat këtë vit apo vitin tjetër është krejt diçka tjetër. Madje nga viti 2010 jemi në proces të një katalogu, të sistematizimit të vendeve të punës dhe harmonizimit të pozitave të punës, por që kjo nuk ka ndodh deri tani në praktikë, mirëpo sinqerisht shpresoj se tani jemi në fund të këtij procesi sepse besoj se ligji për pagat do të miratohet në këtë vit ku do të ketë harmonizim të koeficientëve për punë të njëjtë pagë e njëjtë, e që do të eliminonte diskriminimin në këtë aspekt, edhe pse konsideroj se edhe atëherë do të ketë diferenca me përqindje të vogël por jo sikurse që jemi sot. Si mund të jemi të kënaqur kur një zyrtar i ofiqarisë paguhet me koeficient 5, kur një zjarrfikës është me 4.8, kur një roje e pyllit është me 4.5, dhe këtë, ashtu siç po e them këtu sot e kam thënë edhe në prezencë të Drejtorit të Buxhetit në nivel qendrorë, qoftë para dy viteve qoftë edhe para rreth dy javëve me rastin e dëgjimit buxhetor për Qarkoren buxhetore 2019/02, konkretisht i kam thënë, i nderuar drejtor tregom nëse ju ndokund në Qeveri keni koeficient të tillë, ose që vazhdimisht kërkoni nga zjarrfikësit intervenime në zjarre etj, kurse nuk lejoni rritje të paktën në 5.5, nuk kishte koment e

as përgjigje, por unë prezantova dokumentet dhe ligjin për buxhetin i cili duhet të zbatohet ashtu siç është i planifikuar dhe i miratuar e që për mendimin tim duhet të implementohet 100% ashtu siç është miratuar, por që nuk po ndodh për shkak të përzierjes së kompetencave dhe fuqisë së nivelit qendrorë e cila po zbatohet fatkeqësisht në krahasim me nivelin lokal atëherë kur nuk duhet dhe tani jemi këtu ku jemi. Askush nga ne nuk besoj se jemi të kënaqur që një zjarrfikës ta ketë koeficientin 4.8, madje për mendimin tim edhe 7 është pak, por ajo që vlen të ceket rreth kësaj pozite është se me vite të tëra niveli qendror nuk e merr në menaxhim shërbimin zjarrfikës sepse ky shërbim duhet të jetë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme - MPB, madje madje para rreth 3-4 viteve tërë dokumentacionin e shërbimit në fjalë qoftë për stafin qoftë për makineritë e të ngjashme, i kemi dërgua në MPB në mënyrë që kjo Ministri të merr në menaxhim ngase sipas ligjit është kompetencë e tyre. E njëjta gjë është edhe sa i përket inspektorëve të tregut për të cilët vazhdimisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – MTI kërkon nga Komuna informata lidhur me inspektorët në fjalë në mënyrë që ata inspektor të transferohen në kuadër të asaj Ministrie sepse ligji e parasheh ashtu, por edhe përkundër kësaj ne kemi qenë gjithëherë kooperativ por që asnjëherë nuk është bartë një kompetencë e tillë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, drejtori parafolës përmendi disa akte ligjore dhe dokumente tjera nënligjore, por çështja e sistemit të pagave reflektohet në të gjitha nivelet e shtetit, madje mendoj se sistemin më të keq që mund ta ketë një shtet sa i përket pagave është Kosova, ngase një sistem i tillë i pagave mund të aplikohet maksimum 2-3 vite dhe atë pas luftërave, pas tërmeteve të mëdha, pas kataklizmave që do të thotë se është sistem jashtë të gjitha standardeve. Është bërë përpjekje të bëhet klasifikimi i vendeve të punës dhe përpjekje tjera lidhur me këtë fushë por edhe përkundër Ligjit 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, që është miratuar në vitin 2010, asnjëherë nuk është zbatuar, me përjashtim të 0.05 % të përvojës së punës, mirëpo megjithatë çdo punëdhënës dhe çdo autoritet që është organ i punësimit ka për obligim të ‘luftoi’ me bazën ligjore dhe praktikën përkatëse në mënyrë që të mos diskriminoj punonjësit e vet, kurse për diskriminimin që iu bëhet punëtorëve të të gjitha sektorëve në Kosovë jemi në dijeni të gjithë dhe nuk kemi çfarë të diskutojmë. Unë e di se është pak që për punonjësit të bëhet një shkresë ngase për punonjësit duhet të ‘luftohet’, për punë dhe titull – pozitë të njëjtë duhet të paguhet njësoj. Kështu që ne e ngritëm këtë çështje sepse parimet themelore të trajtimit të barabartë, mos diskriminimit apo mbrojtjes nga diskriminimi është i garantuar me ligj. Kam pyetje dhe dua përgjigje konkrete, sa Marrëveshje për shërbime të veçanta apo siç njihen në opinion kontrata mbi vepër, ka kjo administratë komunale dhe sa është shuma që paguhet për këtë kategori të të punësuarve.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, përgjigje parafolësit, theksoi, lidhur me pyetjen e parafolësit shpresoj se shumë shpejt do të jap përgjigje, por jo sot sepse nuk mund të them asgjë në mënyrë specifike, por sigurisht në mbledhjen tjetër do ta marrësh një përgjigje të tillë qoftë për numrin e punëtorëve përmes formës Marrëveshje për shërbime të veçanta qoftë për koston e tyre.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, rreth raportit financiar për periudhën përkatëse shqetësimi më i madh ishte rreth dinamikës së shpenzimeve kapitale, mirëpo unë do të fokusohem sa i përket DSHPMSH nga 527,434.00 € grant, kjo Drejtori ka shpenzuar 367,808.00 € që i bie 69.79%. Investimet janë ende të ulta sepse kryesisht ka trend të ndryshme në segmente të ndryshme të cilat mund edhe të diskutohen, por unë jo më larg se dje e kam analizuar raportin e shpenzimeve deri në fund të muajit korrik ku shpenzimet janë rreth 538,000.00 € brenda DSHPMSH që dua të them se përveç punëve në gjashtëmujorin e parë ka pas punë të kryera por edhe që kanë qenë në proces të kryerjes por që nuk kanë mund të përfshihen në shpenzime në raportin gjashtëmujorë në disa segmente dhe në disa projekte të ndryshme. Tani jemi në muajt ku kërkohet një intensifikim i realizimit të projekteve posaçërisht i atyre fushore, e them këtë ngase në një mënyrë në disa

projekte ka ndikuar edhe paksa moti jo i përshtatshëm për punime, kështu që në kuadër të DSHPMSh projektet që janë me shpenzime të larta buxhetore siç janë trotuaret, ndriçimi, e të tjera të ngjashme në shumë rreth 530,000.00 €, janë në procedurë e sipër dhe mund të kryhen në periudha të ardhshme brenda vitit.

Shqetësim tjetër të cilin ndoshta Drejtori i DBF ka qenë më mirë ta paraqet është mungesa e rishikimit të buxhetit nëpër Komuna, e them këtë sepse çdo herë në këtë periudhë kohore është bërë rishikimi buxhetor i cili për nga praktika lehtëson shpenzimin e buxhetit në njësitë buxhetore dhe iu ndihmon Drejtorive realizimin e buxhetit dhe Komunave në përgjithësi sepse përfshihen projekte të reja, hiqen projekte apo plotësohen ndryshohen një numër i projekteve, mirëpo në këtë vit rishikimi pamundësohet dhe paraqet një pengesë serioze për Komunitat, madje tani më unë brenda Drejtorisë e kam bërë një rishikim të brendshëm dhe një pjesë e buxhetit rreth 10% ka mund të bartet përmes rialokimit në projekte të reja që do të mund të kryheshin brenda një periudhe shumë të shkurtër, por që pamundësia e një gjëje të tillë i ka vënë në vështirësi të gjitha Komunitat e Kosovës duke përfshirë edhe Komunën tonë, kjo për faktin se jo çdo herë shumat e planifikuara mund të jenë të sakta në raport me ofertat dhe kryerjen e punimeve në terren. Shpresoj se në bazë të planifikimeve të proceduara në prokurim për projekte të ndryshme, fundin e vitit do ta presim shumë më suksesshëm dhe raporti për vitin 2018 do të pasqyrojë punën tonë në raport me realizimet e planifikuara. Sa i përket shpenzimeve tjera, sigurisht të gjithë jemi në dijeni se disa shpenzime janë reale dhe të nevojshme, madje shpesh ndodh që kërkohet të zvogëlohen shpenzimet për mallra dhe shërbime ndërsa unë mendoj se ato jo çdo herë duhet të zvogëlohen por duhet të jenë të arsyeshme, përkundrazi në këtë kategori çdo herë Komunitat kërkojnë buxhet më shumë sepse shërbimet janë duke u rritur në vazhdimësi kurse investimet kapitale janë në rënie në çdo Komunë, por edhe përkundër kësaj buxheti për mallra dhe shërbime nuk po rritet, madje po ndodh të ketë zëra që pse po shpenzohen.

z.Bajram Ajeti, theksoi, fillimisht më vie keq prej Drejtorit të DBF i cili nuk pati përgjigje rreth kontratave mbi vepër, por e ka përgjegjësin për prokurim, madje edhe mjekët të cilët kanë nga rreth 27-28 vite përvojë i kanë larguar dhe tani së fundmi i kanë marrë me kontrata mbi vepër etj etj, andaj për këtë po presim përgjigje më të qartë sepse këto janë shpenzime së koti, dhe atë për poste të cilat janë përhershme në sektorë të caktuar. Ne patëm kërkuar një raport të prokurimit për janar – qershor të vitit të kaluar, nuk është sjellë, pastaj raporti i vërsimeve po ashtu nuk është sjellë asnjëherë e kështu me radhë, mirëpo dua t'i them Drejtorit të DSHPMSh, nuk është problem i vetëm shpenzimi i buxhetit por për ato shpenzime a jeni duke u përpjekur t'i bëni me cilësi, e jo të bëni asfalt të "shtjerrtë", pastaj kanalizimet e juaja i bartë uji nga Batllava në Gërdoc, etj. Gjithashtu çështje tjetër është edhe sjellja e Raportit të Auditorit gjeneral sepse jam në dijeni se ju është sjellë dhe e keni analizuar, andaj kërkoj të shqyrtohet ai raport në mbledhjen e radhës ngase sa jam në dijeni ka gjetur shumë shkelje ligjore por edhe keq menaxhim të mjeteve financiare.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht që do ta kemi për diskutim edhe raportin e Autorit të Përgjithshëm brenda afatit ligjor.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket planit dinamik të investimeve kapitale mund t'ju njoftoj se që nga muaji mars kur kam marrë detyrën e Drejtorit të DPUMM rreth 98% e dokumentacionit janë në procedura të prokurimit dhe një pjesë e tyre veç kanë përfunduar, punimet kanë filluar në disa fshatra. Në fakt siç e dini buxhetin për investime kapitale e përbëjnë pothuajse dy Drejtori, DPUMM dhe DSHPMSh, mirëpo sa vërejtja nga parafolësit ka shqetësim rreth realizimit të buxhetit e që është shumë reale të ketë shqetësime të tilla, mirëpo unë ju garantoj se projektet që i kemi të planifikuara janë në vazhdimësi dhe do të përfundojnë sipas planifikimeve të parapara, e them këtë sepse kemi dy-tri projekte të mëdha të cilat kanë shuma të mëdha të

kostove të tyre, ku njëri është mbi 1 milion euro i cili tani më veç ka filluar në pjesën e rrugës “Zahir Pajaziti” që është projekt madhor i Komunës si dhe projekte tjera të shumta në fshatra të ndryshme. Po ashtu ju informoj se Komuna e Podujevës për dallim nga Komunitet tjera që nuk e kanë bërë një gjë të tillë, në këtë vit ka asfaltuar rrugë mbi 15 km qysh në muajin maj, mirëpo jemi në përpjekje të vazhdueshme të vazhdojmë me realizimin e projekteve të mëdha që ka Komuna ku presim që në muajin shtator t’i realizojmë ato por edhe jemi në pritje të rezultateve të projekteve. **z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar këshilltarë tjerë për të marrë fjalën, edhe pse nuk parashihet që raportet e tilla t’i nënshtrohen procesit të votimit për shkak se është diçka që ka përfunduar dhe nuk mund të kthehen siç është rasti i shpenzimeve dhe gjërave tjera të ngjashme, unë për hir të demokracisë dhe transparencës e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 17 vota për, 15 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, u miratua Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – qershor 2018

5. Informatë për përfundimin e vitit shkollorë 2017/2018

z.Agim Blakqori, U.D. Drejtor i DKA, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, DKA së bashku me gjithë akterët përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimorë kemi bërë të gjitha përgatitjet dhe kemi ndërmarrë të gjitha masat që përmbyllja e vitit shkollor 2017/2018 të bëhet me sukses. Çështja kryesore që dua të ndalem është se nga viti i kaluar të gjitha shkollat e Kosovës ju kanë nënshtruar një reforme serioze përkatësisht jemi duke zbatuar kurrikulën e re të arsimit parauniversitar ku fillimisht janë përzgjedhur tri shkollat e mesme që janë në qytet për të vazhduar pastaj edhe shkollat tjera. Të gjithë ne që jemi një mënyrë akterë në procesin mësimor jemi në dijeni se reforma e cekur fillimisht ka paraqitur vështirësi dhe shqetësim në disa prej akterëve kryesor të cilët janë marrë me këtë problematik duke filluar nga dokumentet e hartuar, pastaj hartimi i testeve, planet dhe programet tjera, mirëpo megjithatë Ministria e Arsimit Shkencës dhe teknologjisë – MASHT, ka arritur që t’i rishikoj ato dokumente dhe të filloj të zbatoj në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar. Në bashkëpunim me MASHT kemi organizuar trajnime me të gjithë mësimmdhënësit të cilët do ta zbatojnë kurrikulën e re, për të cilën një grup i mësimmdhënësve janë përgatitur për t’i trajnuar të tjerët sa i përket zbatimit të kësaj kurrikule sepse është një reformë e cila ashtu sikurse reformat tjera sjell ndryshim dhe ne jemi të përkushtuar të zbatojmë të gjitha politikat e MASHT-it. Gjithashtu DKA në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim ka zhvilluar vizita sistematike përmes zyrtarëve të DKA-së në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës.

Në vazhdim foli për subvencionet - ndarjen bursave për student dhe nxënës, ndarjen e mirënjohjeve nga ana e Kryetarit të Komunës për të gjithë nxënësit e dalluar, veteranët e arsimit, dhe të tjerë. Po ashtu informoi rreth përfundimit të vitit shkollor në fjalë, rezultatet duke përfshirë ato të testit të maturës, dhe të arritshmërisë dhe rezultate tjera të cilat veç janë në informatën me shkrim, duke theksuar edhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollorë, regjistrimin e nxënësve në klasë të I-rë dhe shpalljen e konkursit dhe regjistrimin në klasë të X-ta në shkollat e mesme, shpalljen e konkursit për plotësimin e vendeve të lira të punës dhe përgatitjet tjera për fillimin e vitit të ri shkollor. Gjithashtu përmendi edhe ndërtimin e dy shkollave që janë në proces e sipër dhe renovimin e një numri të shkollave që pritet të filloj shumë shpejt duke nënvizuar që sa i përket renovimit të shkollave është një rregull ku renovimet duhet të bëhen gjatë pushimit në mënyrë që të mos çrregulloj procesin mësimorë, andaj kjo mund të jetë edhe përgjigje ndaj kritikave për mos

shpenzim të buxhetit deri tani. Është bërë dezinfektimi dezinfektimi dhe derratizimi i objekteve shkollare të cilat nuk do të renovohen për të vazhduar me to pas renovimit përkatësisht në fund të muajit gusht. Në vazhdim shtoi, çështja e cila është bërë shqetësim për ne është shkurtimi i 60 vendeve të punës në arsim që është paraparë me Qarkoren buxhetore 2019/01 ndërsa presim dhe shpresojmë që vërejtjet tona të merren parasysh dhe kjo çështje të rirregullohet me Qarkoren buxhetore 2019/02, çështje për të cilën në takime të ndryshme kemi paraqitur këto shqetësime qoftë në MASHT qoftë në MF, në mënyrë qëky shkurtim të bëhet në një afat më të gjatë e jo përnjëherë në vitin 2019. Ne do të vazhdojmë me përkushtim t'i kryejmë punët tona dhe pres nga ju edhe tani por edhe në të ardhmen sugjerime, ide dhe kontribute tjera se si të veprojmë në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme në arsim.

znj.Arlinda Kadriu, theksoi, fillimisht të flasësh për arsimim është një përgjegjësi mjaft e madhe duke ditur se edukimi dhe arsimimi në një shoqëri janë ndër çështjet kryesore të shoqërisë dhe nga e cila varet direkt e ardhmja e vetë individëve e pastaj e gjithë shoqërisë. Në Komunën e Podujevës këtij sektori nuk është se nuk i është kushtuar rëndësi e veçantë në vazhdimësi, dhe po provoj të mos i përsëriti ato që parafolësi i ceku në fjalën hyrëse edhe pse disa prej tyre nuk mund t'i kalojmë pa përsëritur siç është çështja e kurrikulës së re e cila është dokument bazë sipas të cilës duhet të punoj sistemi i arsimit parauniversitar dhe e cila ka filluar të zbatohet në vitin 2013/2014 ku deri tani në disa shkolla ka qenë plot projekt zbatimi i kurrikules e që me plotë përgjegjësi mund të them se ka qenë një sfidë dhe përgjegjësi e jashtëzakonshme jo vetëm në Komunën tonë por në gjithë Kosovën për arsye se ka ardh si një dokument shabllon, nëse mund ta quaj, nga shtetet tjera dhe është kërkuar të aplikohet si i tillë pa përmendur kushtet dhe specifikat tona në raport me shtetet tjera, andaj edhe kemi hasë në aplikimin e saj, mirëpo pas shumë analizave që janë bërë nga MASHT dhe Drejtoritë e Arsimit të Komunave të Kosovës kurrikula është rishikuar dhe është përshtatur dhe ka filluar të aplikohet nga viti 2017/2018 në të gjitha shkollat e Kosovës, por që konsideroj se shihet me shumë skepticizëm sa i përket rezultateve duke përfshirë edhe skepticizmin e një pjese të madhe të prindërve ngase vërtetë është një reformë në arsim, mirëpo pa dashur t'ia bëjë qejfin askujt e as vetës unë me plotë përgjegjësi e them se kam vërejtur se ka rezultate. Meqë në kuadër të kësaj përbërje të Kuvendit ka mësimdhënës siç jam edhe unë, dëshiroj të përmend disa prej rezultateve, shembull, për dallim nga e kaluara tani ka bashkëpunim më të lartë mes mësimdhënësve si në hartimin e programeve lëndore dhe në të gjitha sferat tjera, pastaj tek nxënësit vërehet një ndryshim shumë i dukshëm ku për dallim nga e kaluara ku nxënësit është dashur të mësojnë vetëm nga një libër tani nxënësit janë të lirë të hulumtojnë dhe të përgatitin lëndën nga libra ose burime të ndryshme, do të thotë se suksesi vërehet edhe nga aktivitetet e nxënësve që kanë jashtë procesit mësimorë e që vlen të theksohet se shpesh ndodh në shkollën ku unë punoj të kemi projekte të cilat përgatiten – punohen nga ana e vetë nxënësve, siç janë ato kundër dukurive negative që kanë gjetur mbështetje edhe nga DKA të cilat janë mbajtur brenda shkollës dhe qysh tani ata nxënës e ndjejnë vetën të përgjegjshëm dhe kontribuues të bashkëmoshatarëve të tyre, pastaj përgatitja dhe tërheqja e projekteve edhe nga jashtë ku vlen të ceket njëri prej tyre që ka qenë nga Korpusi i Paqes, që është zhvilluar në Gjimnazin “Aleksandër Xhuvani” ku nxënësit përveç tjerash kanë mësuar se si të përgatiten për tregun e punës në të ardhmen, përgatitja e CV-ve, intervistave etj.

Sa i përket stafit në shkollat e Komunës së Podujevës, mendoj se janë mjaft të përgatitur, me përjashtim të ndonjërit prej tyre sepse gjithçka 100% nuk mund të jetë, por që konsideroj se kur kemi të bëjmë me kritika apo vërejtje në stafin arsimor duhet secili të përmend individualisht me emër për raste konkrete, e jo të përfshihet i gjithë stafi arsimor në Komunën e Podujevës. Në këtë aspekt vlen të ceket se janë testuar një numër i mësimdhënësve që janë trajnerë të kurrikulës së re

e që në listat e rezultateve kanë dalë ndër të parët, dhe përveç kësaj janë mbajtur trajnime brenda Komunës dhe jashtë saj. Po ashtu kemi mësimdhënës nga Komuna e Podujevës të cilët janë duke marrë pjesë në hartimin e programeve lëndore nga të cilat në një të ardhme të afërt do të shkruhen edhe tekstet shkollore, çështje për të cilën mendoj se është një nderë për Komunën tonë. Tregues tjetër i arsimit në Komunën e Podujevës është edhe nota mesatare e që në përgjithësi në shkollat e Komunës së Podujevës është një notë mesatare bukur e mirë në të dyja nivelet, po ashtu edhe në testin e arritshmërisë dhe atë të maturës kemi një rezultat bukur të kënaqshëm dhe ajo që ka qenë më e mira është se nxënësit tanë janë pranuar përkatësisht kanë dalë ndër më të mirët në fakultete dhe departamente të ndryshme siç janë në Fakultetin e Mjekësisë, Shkencave kompjuterike, Kimi Inxhinierike etj ku në shumicën prej tyre kanë qenë të parët, kështu që personalisht unë ndihem e kënaqur me këtë rezultat por duke mos përjashtuar angazhimet e vazhdueshme për një arsim sa më cilësorë në Komunën e Podujevës, por që të paktën ta vlerësojmë pozitive atë që është për tu vlerësuar. Lirshëm mund të cekë disa shqetësime të cilat janë edhe shqetësime të prindërve e ndoshta edhe të një numri të kolegëve mësimdhënës të cilat i vërejme për nga dimensionin praktik që ballafaqohemi ne, fillimisht është zvogëlimi i numrit të punëtorëve në vitin 2019 e që shpresoj se do të ndërmerret diçka në këtë drejtim nga ana e nivelit qendror, tekstet shkollore të cilat janë sjellë tani me reformën e re, programet lëndore të sjella nga MASHT, temat që janë brenda atyre programeve lëndore nuk përkojnë me temat dhe njësitë aktuale që janë në tekstet aktuale, dhe kjo paraqet një konfuzitet tek nxënësit edhe përkundër asaj që ne gjatë gjithë kohës i orientojmë ata se duhet të përdoret material shtesë, hulumtime duke iu ofruar edhe ne vetë materiale të tilla, por prapëseprapë është një lloj shqetësimi. Sa jam në dijeni deri në vitin 2021 është paraparë të shkruhen të gjitha tekstet e reja shkollore, mirëpo edhe përkundër që nuk është përgjegjësi e Drejtorive Komunale të Arsimit ndoshta do të ishte mirë që këto të bëjnë një shtytje më të madhe në këtë drejtim në mënyrë që tekstet e reja të shkruhen sa më shpejt, pra posaçërisht tekstet e klasave të I-ra janë të stërngarkuara e që prindërve ndodh tu krijohet një përshtypje se fëmijët e tyre nuk po mund ta gjejnë vetën në tekstet aktuale shkollore ose mësuesit nuk janë duke punuar sa duhet, kur e them këtë nuk dua ta vë në dyshim profesionalizmin e atyre që ka marrë pjesë në shkrimin e atyre teksteve, por personalisht mendoj kështu se dikund është një lëshim në këtë aspekt. Pastaj problem tjetër që sërish ndërlidhet me tekstet shkollore është edhe çanta e rëndë për fëmijët – nxënësit, çështje kjo e cila është cekë dhe është diskutuar si temë në tërë Kosovën, e që edhe kjo ndoshta duhet të rishikohet sepse mendoj se ka tekste të cilat duhet t'i kenë në çanta por që nuk janë fare të nevojshme.

Për fund mund të themi se ka edhe çështje tjera të cilat mund të diskutohen por për të mos marrë kohë më shumë po e përfundoj diskutimin duke shtuar, se për arsim gjithëherë duhet menduar, të rishikohet, dhe të bëhet më mirë, dhe për arsim jemi përgjegjës të gjithë duke filluar nga ne prindërit, nxënësve, stafit, shkollave, Drejtorive të Arsimit e deri tek Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

z.Vendenis Lahu, theksoi, zakonisht në raportet e Organizatave të huaja por edhe ato vendore nuk e nxjerrin mirë arsimin tonë qoftë në nivel qendror qoftë lokal e sigurisht që as Komuna jonë nuk përjashtohet në këtë aspekt, por kjo nuk mund dhe nuk duhet të shërbej si alibi sepse disa nga problemet që ndikojnë në këto rezultate janë lehtësisht të evitueshme. Neve si asamblistë na është ofruar një informatë nga DKA rreth përfundimit të vitit shkollor 2017/2018 e cila nuk është gjithë aq e plotë dhe e detajuar por sido qoftë problemet në arsim janë të njohura deri diku e që janë ato të zakonshme me të cilat po përballemi që sa kohë. Sigurisht në rend të parë është infrastruktura e objekteve edukativo arsimore e cila lë shumë për të dëshiruar duke marrë për bazë edhe buxhetin e ndarë për mirëmbajtje dhe rikonstrukcion duke por edhe shkallën e amortizimit vjetor të tyre.

Nxënësit dhe mësimdhënësit në Komunën tonë ballafaqohen me mungesë të kabineteve të cilat janë të nevojshme për zhvillimin më adekuat të shumë lëndëve dhe njësive mësimore. Në bazë të të dhënave që kemi nga bashkëbisedimet me shumë nxënës dhe mësimdhënësit të Komunës së Podujevës, kurrikula e re për një arsyë apo tjetër nuk po zbatohet në një nivel të kënaqshëm përkundër asaj që DKA po duket të jetë e kënaqur me këtë nivel të zbatimit. Po ashtu mendojmë që Këshillat drejtues të shkollave nuk janë funksionale sa duhet për të mos thënë fare. Problem i përhershëm në Komunën tonë mendoj se është partizimi i institucioneve arsimore e që në këtë aspekt besoj që edhe Ushtruesi i detyrës së drejtorit të DKA-së e ka të vështirë të na përmend ndonjë drejtor të ndonjë shkolle i cili nuk është i lidhur në mënyrë direkte apo indirekte me partinë në pushtet. Nuk besoj se gjithsesi duhet të merret Ushtruesi i detyrës së shkollave me ndonjë parti politike në kuptimin që edhe drejtori është i partisë në pushtet, ai duhet të jetë kompetent dhe duhet ta kryej punën më së miri, por mua më befason fakti që të gjithë drejtorët e shkollave në Komunën tonë rastisin edhe të jenë kompetentë edhe anëtarë të LDK-së. Po ashtu problem tjetër që unë e shoh është edhe rekrutimi i kadrove të reja dhe ndikimi politik që bëhet në këtë proces dhe përderisa ka ndikim politik në këtë proces që është shumë delikat atëherë kjo është një garancë që të rekrutuarit nuk do të jenë më meritoret. Po ashtu kemi edhe një diskriminim do të thoja, në baza partiake të të punësuarave në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Podujevës me favorizime të ndryshme, herë më të lehta e herë më të rënda, por sido që të jetë kjo është gjendja të cilën e kemi. Po ashtu u cek këtu se materiali i nxënësve, sidomos i atyre në klasë të I-ra, ndoshta është paksa i rëndë për tu absorbuar dhe ndoshta është i mbingarkuar për ndonjë nxënës të klasëve të I-ra sepse të gjithë nuk mund të jenë të njëjtë por disa arrijnë të absorbojnë më shumë informacione disa më pak, por mendoj se një faktor këtu në pamundësi të mos absorvimit të kurrikulave të klasëve të I-ra sigurisht është edhe përfshirja jo e kënaqshme e fëmijëve në edukimin parashkollor, dhe në këtë aspekt nuk kam parë që DKA të ketë prezantuar ndonjë strategji se si të rritet përfshirja e fëmijëve në edukim parashkollor e që sigurisht do ta bënte më të lehtë vijimin në klasën e I-rë dhe absorvimin e materialit mësimor.

Komuna jonë ka vetëm një Çerdhe publike e që mendoj se për një Komunë me rreth 90000 banorë besoj se është pak, por edhe ajo ekzistuese oborrin e ka të papërdorshëm për fëmijët për shkak se nuk ka asnjë lodër të vetme për ata, sidomos tani në kohën e pranverës nuk mendoj se fëmijët duhet të qëndrojnë tërë kohën brenda. U tha që DKA në bashkëpunim me këshillin e arsimtarëve sidomos të edukatës fizike ka organizuar turnire sportive në nivel komunal që mendoj se është shumë mirë dhe që duhet të përkrahen maksimalisht dhe të shtohet numri i tyre, madje pse jo edhe dy herë në vit (në fillim të vitit shkollor dhe në përfundim të tij), por në të njëjtën kohë në këtë aspekt unë e shoh një problem goxha serioz që ka të bëjë me shkollën fillore "Naim Frashëri" që është ndërtuar objekti i ri i shkollës por që disa vite nuk ka terren sportiv përkundër asaj që objekti i vjetër i asaj shkolle e ka pasur një fushë e cila ka qenë e përdorshme për nxënësit, mirëpo mendoj se Komuna ka mund ta bëjë një operacion low cost deri në ndërtimin e një terreni sportiv ndoshta sipas standardeve, gjë të cilën e shoh si mosveprim të institucioneve dhe këtu është një neglizhencë dhe një papërgjegjësi e plotë. Në arsimin e mesëm të ulët u ceken edhe rezultatet e testeve të arritshmërisë pastaj kemi edhe notën mesatare e cila është goxha mirë 3.65 e që në përqindje karshi vlerësimit maksimal i bie të jetë 73%, do të thotë kjo është sipas vlerësimeve të mësimdhënësve në Komunën tonë, por nëse kjo krahasohet me testin e arritshmërisë ku kemi një rezultat prej 59%, e që mendoj se është paksa i fryrë dhe këtë e bazoj në përvojën time ngase nuk ka shumë kohë që jam larguar nga banka shkollore, andaj për mendimin tim është një diskrepancë goxha e madhe, ose testi i maturës nuk është real në aspektin e matje së njohurive të nxënësve ose ose vlerësimi nga ana e mësimdhënësve nuk është në nivelin e duhur. Çështje tjetër me shumë rëndësi e që

mendoj se ka qenë gjithmonë në Komunën tonë është edhe mungesa totale e transparencës në ndarjen e bursave për student por edhe për nxënës të shkollave të mesme, dhe në këtë aspekt dëshiroj të shtroj pyetje, a ka Komuna rregullore për ndarjen e bursave, nëse po cila është ajo dhe kur është miratuar, nëse jo me çfarë kriteresh Komuna ndan bursa për nxënës dhe student, përse ato kriteret nuk bëhen publike në mënyrë zyrtare dhe përse nuk publikohen të dhënat e plota të përfituesve të bursës si dhe poentimi në bazë të kriterëve të paracaktuara.

z.Fatmir Rudari, theksoi, rreth arsimit u than shumë gjëra nga parafolësit por unë do të ndalem tek reduktimi i 60 vendeve të punës, shqetësim ky i cili është edhe tek ne. Nuk e di si është menaxhuar nga Drejtoria e Arsimit por për çdo vit është bërë pranimi i kuadrit nga kjo Drejtori dhe tani del që 60 mësimdhënës duhet të mbetën pa punë, mësimdhënës ku shumica prej tyre punojnë që mbi 20 vite në arsim, kurse tani i bie që të nijetit do ta humbin vendi e tyre të punës. Po ashtu është edhe problemi tjetër ku çdo i treti mësimdhënës pothuajse në Komunën e Podujevës është jo me normë të plotë, gjë e cila mendoj se ndikon edhe tek rezultati i nxënësve që është pothuajse i përafërt, pra çdo mësimdhënës qysh në muajin shtator duhet të mendoj se a do të filloj të punoj me 10 orë, 12 orë apo me 15 orë, problem ky i cili po e përcjellë me vite të tëra arsimin në Komunën e Podujevës. U fol shumë edhe për kurrikulën e që edhe unë jam ndër ata mësimdhënës që e aplikojmë kurrikulën e cila është fakt se ka vështirësi sepse jemi në fazën fillestare të aplikimit të saj por që mungojnë kushtet nëpër shkolla sepse kërkohet të ketë internet nëpër shkolla, kompjuter, projektor etj për tu zbatuar kurrikula në tërësi. Gjithashtu tekstet shkollore nuk janë të harmonizuara me kurrikulën e re dhe po na krijon vështirësi neve si mësimdhënës por meqë ka qenë si pilot projekt dhe tani ka filluar të zbatohet andaj edhe besoj që do të ketë përmirësime në të ardhmen.

Shqetësim tjetër është edhe ndarja e bursave në Komunën e Podujevës gjë të cilën e ceku edhe parafolësi, unë nuk di se çfarë kriteresh janë përdorur por mua më është paraqitur një student me notën mesatare 9.11 të cilit i është refuzuar bursa në Komunën e Podujevës, dhe që i ka edhe dy anëtarë tjerë të familjes e që është edhe një kriter shtesë, ndërsa në fshatin Batllavë janë ndarë 5 bursa ku prej tyre 3 janë shkuar për një familje dhe 2 të tjera për një familje tjetër, do të thotë një familje 3 bursa, tjetrës familje 2 bursa kurse një studentit me notën më të madhe mesatare në atë proces 9.11 nuk i është dhënë bursa. Shqetësim tjetër është edhe çështja e mësimdhënësve të cilët po dalin në pension por që nuk po mund ti marrin tri paga shtesë, gjë kjo e cila është me ligj, por që nuk kam informata se ndokush ka marr pagat e tilla në Komunën e Podujevës mirëpo vetëm disa mirënjohje po jepen nga Kryetari i Komunës me rastin e shkuarjes së pension, kurse në disa Komuna tjera kam informacione se i marrin tri paga shtesë mësimdhënësit me rastin e shkuarjes në pension. Po ashtu kam pyetje për Drejtorinë e Arsimit, si do të ndahet mësimi zgjedhor nga shtatori dhe a keni bërë ndonjë projekt për këtë, sepse e di që ende nuk është ndarë dhe bëhen shumë kalkulime për këtë çështje, si dhe pyetja tjetër është rreth orarit të punës së bibliotekistëve me normë të plotë, konkretisht çfarë orarit të punës kanë.

z.Avni Islami, theksoi, nga parafolësit u diskutua shumëçka për arsimin, mirëpo në mbledhjen e kaluar unë e kam shtruar një pyetje Ushtruesit të drejtorit të DKA-së lidhur me shkollën aneks “Kadri Kadriu”, e që pothuajse gjysmën e problemeve të asaj shkolle nuk i kam cekur. T’ju them të drejtën ajo shkollë është në gjendje të mjerueshme, mungojnë kushtet elementare, mund ta vërtetoni secili prej jush, ajo shkollë është sikur të ishte në Afrikë, pa ujë të pijes, pa tualete si dhe në atë shkollë mbahen tri ndërrime. Unë e kam fëmijën tim në atë shkollë, por këtë problem po e paraqesë në emër të bashkëfshatarëve të cilët më kanë kërkuar ta paraqesë këtë problem në Kuvendin e Komunës. pra në atë shkollë përveç tjerash punohet me tri ndërrime dhe janë vetëm dy klasë dhe kështu nxënësit mbajnë vetëm 1/3 e orarit të plotë mësimorë ku thuajse një orë është

më pak se 20 minuta, kjo është shqetësuese. Besoj se U.D i Drejtorit të DKA-së do ta ketë parasysh këtë sugjerim dhe kërkesë timen dhe para se të filloj mësimi të bëhet zgjidhje për atë shkollë.

Unë e kam propozimin tim e që mendoj se shkolla në Dumnice të Poshtme ka hapësirë të mjaftueshme, pra të barten nxënësit në këtë shkollë dhe të mundësohet mësimi normal në Shkollën “Kadri Kadriu”, përndryshe unë si prind në këtë rast do ta tërheqë fëmijën tim nga ajo shkollë dhe së bashku me mua janë të gatshëm edhe prindërit tjerë t’i tërheqin fëmijët e tyre për shkak se ajo shkollë nuk i plotëson kushtet minimale për të zhvilluar mësim normal.

z.Vendenis Lahu, theksoi, edhe një çështje shtesë përveç atyre që i ceka paraprakisht, fjala është rreth ndarjes së bursave që u cek nga z.Fatmir Rudari, nuk është se Komuna jonë ka refuzuar vetëm njëherë bursa të nxënësve dhe studentëve të dallueshëm, madje ka refuzuar ndarjen e burës për një student të Fakultetit të Mjekësisë me notë mesatare 10.0 e që konsiderohet se prej themelimit të fakultetit të cekur nuk ka pas student më të mirë se ai por që Komuna jonë ka refuzuar bursën.

z.Bajram Ajeti, theksoi, mendoj se këto që u cekën janë shqetësime të mëdha dhe që i kundërvihen atyre diskutimeve nga ana e pozitës që ishin të lehta dhe të buta ku madje u krahasua edhe me “Europën”, mirëpo unë kam një propozim dhe një pyetje, dhe atë; pyetje, a keni raport se sa analfabetë prodhohen nga arsimi në Podujevë, pse e them këtë, profesor z.Osman Ejupi është profesor në Universitet dhe një ditë rastësisht u takove me atë, ishte mjaft i shqetësuar ngase siç tha vijnë nxënës të cilët nuk dinë shkrim – lexim, andaj lidhur me këtë ekziston një praktikë kush atakohet lidhur me këtë, por kush punon në administratë e dinë shumë mirë se si e kemi gjendjen në arsim e që unë nuk do ta paraqitja aq të mirë sepse gjendja është alarmante dhe për këtë temë fillimisht është dashtë të raportohet si ishte në vitin 2017, e jo të ndërlihet tema se si do të bëhet arsimi ngase faktikisht ose kemi të bëjmë me fshehje të informatave të gjendje reale që është në terren ose përpjekja për tu arsyetuar kinse unë do të bëjë këtë ose atë me qëllim të mbajtjes së pozicioneve. Çështja tjetër që ishte rreth studentëve gjegjësisht ndarjes së bursave, mendoj se është çështje urgjente që të nxirret një rregullore nga ky Kuvend e cila do të përcaktoj kriteret për ndarjen e bursave qoftë për studentë qoftë për nxënës të shkollave të mesme, sepse në qoftë se ka raste siç u pamenden e që besoj se ka ngase kolegët kanë marrë informacione, siç ishte rasti ku në një familje janë ndarë tri bursa dhe në familjen tjetër dy bursa, kjo është keqpërdorim i hapur i mjeteve publike dhe që duhet t’i nënshtrohet drejtësisë, dhe në këtë aspekt si ka fytyrë ai komision të del para qytetarëve apo nëse është urdhëruar nga ndokush, si ka fytyrë ky i fundit të keqpërdor taksën e popullit duke ndarë bursa në këtë formë. Kështu që nuk është gjendje ashtu siç paraqitet nga pozita por është gjendje më e mjerueshme, pastaj kemi parë gjendjen e krijuar në arsim nga drejtori paraprak i cili pothuajse e shkretoj shkollën “Enver Maloku”, kështu që duhet t’i lëmë maskat dhe të hymë në esencë të problemeve për të bërë punën ashtu si duhet sepse e kemi obligim, dhe të mos marrim përgjegjësi nesër për punët që si kemi bërë sot, ngase edukimi – arsimi jo rastësisht është quajtur hyjneshë e kësaj bote.

z.Patriot Rudari, theksoi, viti shkollorë 2017/2018 në Komunën e Podujevës mund të them se ishte goxha i suksesshëm, dhe dëshiroj të ndalem paska tek Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani” ku edhe punoj, në këtë vit mësimorë nxënësit e Gjimnazit kanë arritur sukses të jashtëzakonshëm ku pothuajse kanë arritur sukses sa i përket përfundimit të mësimave, notimit, pastaj testin e maturës e kanë kaluar 97% të nxënësve dhe pothuajse shumica e tyre janë regjistruar në Fakultete, madje një numër i madh edhe në atë të Mjekësisë. Në drejtimin Natyrorë nota mesatare është shumë e lartë, mbi 4, kurse në drejtimin shoqërorë është pak diçka më e ulët, rreth 4. Sa i përket trajtimit të mësimdhënësve mund të them se nuk trajtohen të gjithë njësoj ku çdo herë të njëjtit mësimdhënës janë në komisione të ndryshme, si në Këshill të prindërve, si me nga dy klasë - tri klasë, dhe kjo gjendje ende vazhdon ngase drejtori i shkollës është po ai e që ndoshta është i pazëvendësueshëm.

Po ashtu u cekë edhe çështja e tri pagave me rastin e pensionimit të mësimdhënësve, sa jam në dijeni disa Komuna i japin pagat në fjalë, andaj është mirë të jepen edhe nga Komuna e Podujevës ngase ashtu – kështu përmes gjykatës të njëjtat po i realizojnë.

z.Agim Blakqori, U.D. Drejtor i DKA, se kemi suksese në arsim në vitin 2017/2018 është e pamohueshme dhe nuk mund ta mohojmë një gjë të tillë sepse janë faktet dhe çështjet tjera që tregojnë. Se kemi probleme dhe vështirësi në zbatim të kurrikulës, mund të themi është në nivel vendi dhe jo vetëm tek ne në Komunën e Podujevës ngase çdo reformë sjellë vështirësi dhe dilema. Të kemi parasysh se një pjesë e stafit mësimor janë bukur në moshë të shtyrë dhe me këtë reformë duhet të përcjellin trajnime dhe punëtori të ndryshme e që është një angazhim shtesë, por me përkushtim të madh të gjitha këto kemi arrit t'ia dalim dhe do të vazhdojmë me përkushtim deri sa t'i arrijmë sukseset tona ngase është politikë shtetërore. Unë edhe nga takimet e herëpashershme që kam me nxënës, jua kam bërë me dije se kemi hyrë në këtë reformë dhe nuk do të ndalemi sepse duhet ta ngrisim arsimin dhe nuk ka kthim mbrapa.

Sa i përket çështjes së ngritur rreth ndarjes së bursave, u tha se nuk ka rregullore e që nuk qëndron një gjë e tillë sepse gjithherë shpallet konkursi për aplikim ku parashihen kushtet dhe kriteret përkatëse dhe nuk është vetëm një kriter nota mesatare, pastaj ka qenë një kriter ku është kërkuar përfshirja e sa më shumë nxënësve dhe studentëve që kanë nevojë. Jemi në dijeni se studentët e mirë duhet ti motivojmë disi por ata e kanë edhe bursën në Universitetet përkatëse, kurse në konkurse është një kriter ku thuhet përfituesi duhet të jetë përfitues i vetëm një burse e që në këtë rast ata studentë janë përfitues të bursave të ndara nga Universiteti që është shumë më e madhe e mjeteve buxhetore. Kemi pas një rast ku dy anëtarë (njëri nxënës dhe njëri student) të një familjeje nga fshati Batllavë kanë qenë përfitues të bursës së ndarë nga Komuna, gjë e cila fillimisht nuk është vërejtur nga Komisioni përkatës mirëpo pastaj komisioni ka kontaktuar me ata të dy ku njëri prej tyre në mënyrë vullnetare ka heqë dorë nga bursa e cila pastaj i është ndarë atij që ka qenë në radhë në bazë të vlerësimeve të Komisionit, pra ky është një rast që ka ndodh kurse për rastet e cekura nga parafolësit nuk kam informacione. Çështje tjetër sa i përket ndarjes së bursave, janë disa kritere siç janë nxënësit-studentët me nevoja të veçanta, nota mesatare, dy e më shumë student të një familjeje e të tjera të cilave natyrisht se ju jepet përparësi dhe të gjitha këto grumbullohen, bëhet ranglista dhe publikohet. Sa i përket çështjes së mësimi zgjedhor është çështje e brendshme e shkollave që trajtohen në bazë të interesave të nxënësve, por nëse vërejmë se ndokund nuk është duke u respektuar normativi për këtë çështje ne ndërmarrim masa dhe i sqarojmë çështje të tilla.

Ndërtimi i terrenit sportiv në shkollën “Naim Frashëri”, ka hyrë në planifikime dhe pritet të ndërtohet, por me përfitimin e grantit nga investitori i asaj shkolle që ka qenë, i cili ka thënë se në rast të mirëmbajtjes së mirë të shkollës, do të jeni edhe përfitues të një salle të sporteve, e që në një mënyrë ajo shkollë është në garë, por që nuk përjashtohet edhe ndërtimi i terrenit sportiv që ka hyrë në planifikime e që gjatë këtij viti presim të realizohet.

Përfshirja në edukimin parashkollorë mendoj se jemi kampion në nivel vendi dhe këtë e bazoj në takimet që kam pasur me kolegë të Komunave të ndryshme, po thuajse 90% të nxënësve janë me edukim parashkollorë, e kemi të shtrirë rrjetin e edukimit parashkollor pothuajse në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës, dhe kjo është një e arritur me vite të tëra, dhe kohë pas kohe ku kemi parë të arsyeshme e kemi zgjeruar rrjetin e edukimit parashkollor.

Sa i përket reduktimit të 60 vendeve të punës, besoj se e kemi sqaruar mjaft këtë çështje, pra kemi zvogëlim të numrit të nxënësve e që numri i mësimdhënësve është i ndërlidhur me numrin e nxënësve andaj edhe kjo ndikon në shkurtimin e vendeve të punës por ne duhet të mendojmë që të planifikojmë të ardhmen që mos të shpallim vende pune aty ky mund t'i plotësojmë normat me mësimdhënës aktual.

Sa i përket tri pagave përcjellëse për pensionistët e arsimit, nga viti 2011 i kemi planifikuar me qarkore buxhetore, mirëpo Qeveria në kohë fushatash zgjedhore ka marrë vendime të tilla por asnjëherë mjete buxhetore nuk kanë ndarë për këtë çështje, ndërsa nga viti 2019 i kanë planifikuar mjetet në fjalë edhe pse nuk i mbulojnë të gjitha shpenzimet ku shembull në vitin 2019 janë mbi 40 mësimdhënës të cilët dalin në pension kurse ndarja e buxhetit është bërë për rreth 25, dhe përsëri nuk do të mund të mbulohen të gjitha ato shpenzime, ndërsa raste të tilla jam në dijeni se mund të iniciohen përmes gjykatave sepse është e drejtë e tyre, por shpresoj se meqë janë ndarë mjete për këtë çështje do t'i japim zgjidhje.

Orari me normë të plotë për bibliotekistët është i njëjtë 8 orë dhe duhet ta respektojnë të gjithë. Sa i përket çështjes së ngritur nga këshilltari i Kuvendit z.Avni Islami, që ka të bëjë me shkollën "Kadri Kadriu", sa jam në dijeni unë fjala është për shkollën e cila është në planifikim në vitin 2019 për tu ndërtuar objekt i ri nga MASHT, andaj çfarë duhet të bëjmë ne diçka tjetër përveç të presim edhe pak kohë që të ndërtohet objekt i ri, gjë të cilën duhet ta kemi të qartë të gjithë se investimet kapitale në sektorin e arsimit i bartë MASHT dhe në këtë aspekt Komuna e Podujevës kah kohë të gjatë që është duke u diskriminuar, por ka raste që Komuna e Podujevës një pjesë të buxhetit për investime kapitale e orienton për investime në objektet edukative arsimore siç ishte rasti i shkollës "Dituria" në fshatin Llapashticë të Poshtme, edhe përkundër asaj që është në kompetencë dhe përgjegjësi të MASHT, çështje për të cilën pres edhe nga një pjesë e opozitës që gjëra të tilla t'i ngritin edhe tek bashkë partiaket e tyre në nivel qendrorë sepse është diçka që na takon si Komunë, nëse ndahet buxhet në bazë të ndonjë formule të caktuar për grantin specifik përse mos të ndahen edhe investimet kapitale për Komunën e Podujevës, mirëpo disa herë kemi vërejtur se në disa Komuna ndërtohen shkolla shumë të mëdha, kurse në disa Komuna anashkalohen investime të tilla mëse të nevojshme.

z.Avni Islami, theksoi, sqarim parafolësit, fjala është për gjendjen faktike dhe momentale në shkollën "Kadri Kadriu" e jo për investime në të ardhmen, andaj po pyes si të bëjmë një zgjidhje kur kemi parasysh që vitin e kaluar mësimor gjendja në atë shkollë ishte e mjerueshme, asgjë nuk po kërkojmë më shumë se gjetjen e një zgjidhjeje për daljen nga ajo situatë emergjente derisa të ndërtohet objekti i ri i shkollës. Po e ripërsërisë se gjendja faktike është emergjente dhe po ta vizitoj inspektorati sanitar sigurisht se do t'i duhej t'ia vë dryrin asaj shkolle, andaj vetëm po kërkojmë të bëhet një zgjidhje emergjente ku ata nxënës do të mund të barteshin në shkollën e fshatit Dumnice të Poshtme në të cilën ka hapësirë të mjaftueshme, kjo do të ishte zgjidhja.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, desha të ndërlihem rreth ndarjes së bursave dhe të jap informatë shtesë. U tha se ata student që kanë notën mesatare 10 bursën e marrin nga Fakulteti, mirëpo një student mund të përfundojë vitin në afatin e shtatorit dhe nuk mund të jetë përfitues i bursës, përndryshe rastin e cekur nga z.Vendenis Lahu për personin në fjalë, unë e njeh personalisht dhe kanë qenë tre familjarë nga një shtëpi, mirëpo me ndarjen e bursave gjithmonë është manipuluar, madje kam qenë edhe vetë aplikuese por që nuk kam përfituar.

z.Fatmir Rudari, theksoi, sa i përket mësimi zgjedhor parafolësi U.D. drejtorit të DKA e tha se është çështje e brendshme e shkollave, konsideroj se vitin e kaluar është dashtë ta aplikoni.

Po ashtu jam në dijeni se shumë mësimdhënës lidhin kontrata vetëm me mësim zgjedhor gjë për të cilën dyshoj se kanë të drejtë. Sa i përket orarit të bibliotekistëve, në fshatin Dyz është një bibliotekistë me juridik e cila punon me normë të plotë por që e cila vetëm dy herë në javë vjen në punë, andaj edhe shtrova pyetje paraprakisht. Sa i përket çështjes së normave, u tha se çdo vit po bie numri i nxënësve dhe nuk kemi çfarë të bëjmë, mirëpo për çdo vit dalin në pension mësimdhënës, mirëpo për një pastaj pranohen dy mësimdhënës të tjerë me nga 10 orë, do të thotë vetëm krijoni gjysma normash, andaj normal pastaj që po krijohen balance jo të mira, ndërsa sa i

përket ndarjes së bursave unë e ceka një rast për të cilin u tha se ka marrë në Universitet, por ai person nuk ka mund të marrë bursë për shkak se ka qenë refuzues i një note. Kriteri është që me notë mesatare mbi 9-të, janë 25 pikë, plus kriter shtesë tjetër ka qenë se i njëjti person ka qenë vet i treti nga një familje, kjo është e vërteta sepse asnjëherë nuk them diçka pa fakte. Pastaj ka student të cilëve për herë të tretë ju është ndarë bursë nga Komuna e Podujevës, unë i di dy raste. Tek familja Berisha në Batllavë ju janë ndarë tre anëtarëve të saj bursë, kurse në familjen Jashari ju janë ndarë dy anëtarëve të saj bursa, këto janë fakte sipas rezultateve të publikuara. Sa i përket notës mesatare në Gjimnaz e që z.Patriot Rudari e vlerësoj si rezultat shumë të mirë, në raport thuhet se është 3.72 nota mesatare, pastaj nota e përgjithshme mesatare në shkolla të mesme është 2.97, e që nuk ka dallim diçka me vitin e kaluar.

z.Arbër Blaku, theksoi, U.D. i Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, përveç tjerash bëri kërkesë tek ne të intervenojmë në Ministri me qëllim të ndihmës për investime kapitale, unë nga kjo foltore ju them se sa i përket Grupit të këshilltarëve të PDK-së, e keni ndihmën tonë për çfarëdo projekti, por edhe kur të vie puna me i zgjedh drejtorët e shkollave dhe me i nda orët, ju lutem të na ftoni edhe në këto procese.

z.Bajram Ajeti, theksoi, në diskutimin tim paraparak harrova një çështje, fjala është se në Informatë ceket dezinfektimi, derratizimi dhe dezinfektimi –DDD, do të dëshiroja të paktën të cekni dy shkolla që ka filluar apo që është bërë DDD sepse kështu na patën gënjyer vitin e kaluar ku ne kërkonim hapësirat shkollore për aktivitete politike, na thuhej se është duke u bërë DDD, kurse në të vërtetë në raportet që kishim me banorë të atyre lokaliteteve, na thoshin se asnjëherë nuk është duke u bërë DDD në shkollat përkatëse. Pastaj do të ishte mirë të na njoftoni se kush është dezinfektues, derratizues dhe dizisektues, qe sa vite është dhe mos rastësisht është ndonjë keqpërdorues. Besoj se jeni në dijeni mirë se kush është ai, po ashtu e dini sepse e keni shpërblyer edhe me pronë publike, kështu që është mirë të na tregoni kush është ai person, andaj kërkojmë informatë për mbledhjen tjetër të radhës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, përgjigje parafolësit, sipas asaj që dëgjova ju qenkeni në dijeni se kush është ai person, andaj për hir të transparencës cekeni emrin.

Sa i përket diskutimeve lidhur me arsimin në Komunën e Podujevës, kishte mjaft gjëra që u ceken dhe që u dhanë sqarime dhe përgjigje përkatëse. Konsideroj të gjithë jemi që arsimi të ketë suksese dhe të ngritët cilësia çdo herë e më shumë. Andaj e konsideroj të mbyllur këtë pikë.

6. Propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për raste të veçanta, përkatësisht fjala është për tri zona kadastrale që i jepen Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë – KBI, çështje kjo e cila lejohet me Ligj. Do të thotë në bazë të kërkesave të komuniteteve të fshatrave Metehi, Shtedim dhe Sallabaj, dhe kërkesës së Këshillit të Bashkërisë Islame në Podujevë, ne kemi proceduar këtë propozim vendim të cilin sigurisht që e keni lexuar dhe analizuar, andaj besoj se do të mbështetet edhe nga ana e Kuvendit të Komunës.

z.Arbër Blaku, theksoi, ka dy-tri seancat e fundit që janë duke u sjellë propozimeve për dhënien e pronave në shfrytëzim, mirëpo ne si anëtarë të Komisionit asnjëherë nuk jemi thirr të njoftohemi rreth dhënies në shfrytëzim të pronave të Komunës, pra ne nuk jemi të informuar asgjë dhe madje

nuk jemi takuar asnjëherë, andaj si pyetje kam, a mund ta dimë se cili është funksioni jonë si Komision për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, sqarim parafolësit, kur kemi të bëjmë me dhënien e pronave komunale për raste të veçanta, ligji përkatës parasheh që për raste të veçanta, siç është rasti në fjalë, komisioni i cekur nuk ka kurrfarë pune sepse nuk është me konkurrencë përmes ankandit, pra kur kemi të bëjmë me dhënien e pronave komunale në shfrytëzim për raste tjera përmes konkurrencës, shembull, siç është lokali ish SHKSH në qendër dhe disa prona tjera, atëherë ju si komision duhet të takoheni dhe të procedoni me raste të tilla, ndërsa për raste të veçanta siç janë kërkesat që vijnë nga niveli qendror, nga ambasadat, për energjetikë, për aktivitete fetare si rasti në fjalë, këtu nuk ka nevojë që dhënia e tyre në shfrytëzim të bëhet përmes komisionit.

z.Avni Islami, theksoi, rreth dhënies së pronave në shfrytëzim për varreza, jo më larg se mbrëmë në media ishte një temë e tillë në një fshat të Komunës së Podujevës, andaj është mendim personal i imi që bartja e kompetencave nga Komuna tek Bashkësi Islame e Kosovës, pa një mekanizëm të kontrollit nuk besoj se është në rregull dhe ka mundësi të manipulimit dhe si rrjedhojë e kësaj kemi edhe kacafytje mes banorëve të një fshati ku përfaqësuesit e BIK deklarohen se në ato varreza nuk mund të varrosen të gjithë banorët e fshatit, pra bëhet seleksionim përkatësisht thuhet që dikush qenka banorë i atij fshati që 1 muaj kurse dikush tjetër që 60 – 100 vite, por nëse prona komunale i është ndarë, Komuna duhet t’ia bëjë me dije BIK-ut se ajo pronë – parcelë e ndarë vlen për të gjithë banorët e atij fshati, dhe askush nuk duhet të ndihet qytetarë ose fshatar i rangut të dytë-tretë etj. Propozoj që përgjegjësit komunal ta vendosin një sistem kontrolli dhe mos tua lënë në duar të lira përfaqësuesve të BIK dhe të fusin përçarje tek qytetarët ku mund të vijnë edhe deri tek ngatërresat, e që pastaj për një situatë të tillë përgjegjëse do të jetë Komuna e Podujevës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, rreth kësaj çështjeje që u cek nga parafolësi kemi biseduar edhe në mbledhjen e KPF-së, përafërsisht jemi marrë vesh dhe jemi për atë që me këto çështje të menaxhohet dhe të ketë kontrolle nga ana e Komunës në mënyrë që mos të ketë probleme të tilla mes qytetarëve. Unë mendoj se të gjithë banorët rezident që jetojnë dhe banojnë në një fshat, e kanë të drejtën që të varrosin anëtarët e tyre në varrezat e fshatrave përkatëse.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, unë dje u njoftova me rastin në fjalë dhe qysh sot në mëngjes kam kontaktuar me Këshillin e Bashkësisë Islame në Podujevë, me ish kryetarin z.Bekim Jashari, pastaj me përfaqësuesin e fshatit z.Sahit Uka dhe me qytetarët tjerë të cilët ishin protagonistë të kësaj çështjeje të cilët në fakt javën e kaluar kanë qenë në zyrë dhe kanë paraqitur brengën e tyre duke aluduar se ju është ndaluar varrimi i anëtarëve të familjeve të tyre në varreza, ndërsa mua personalisht më është interpretuar se nuk qëndron një gjë e tillë sepse ne pronën në fjalë e kemi dhënë në shfrytëzim për të gjithë qytetarët, mirëpo siç më kanë thënë problemi qëndron tek pozicionet – pjesët e asaj parcele se kush ku duhet t’i varrosë familjarët e tyre në të ardhmen, përndryshe atë pronë e ka dhënë në shfrytëzim Kuvendi i Komunës në mandatin e kaluar, mirëpo nëse shohim probleme të tilla në të ardhmen mund të procedojmë dhe ta anulojmë atë vendim. Pra këto që i ceka më janë thënë edhe nga Këshilli i Bashkësisë Islame, edhe nga komiteti i fshatit, përkatësisht problemi është rreth ndarjes së pozitave brenda parcelës së dhënë në shfrytëzim, e jo për mos lejim të varrimit.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë

7. Propozimi i vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, bëhet fjalë për një kërkesë e cila në fakt na është parashtruar së bashku me kërkesat e seancës së kaluar, mirëpo që është bërë një gabim nga ana e përfaqësuesve të KEDS të cilët për fshatin në fjalë kanë paraqitur kërkesë për dhënie në shfrytëzim të parcelave të cilat kur i kemi analizuar kanë dalë të jenë pronë private, andaj nuk e kemi proceduar fare por kemi kontaktuar përfaqësuesit e KEDS dhe jua kemi sqaruar një gjë të tillë. Pastaj KEDS ka pranuar këtë gabim dhe ndër kohë ka paraqitur kërkesë të re duke përmirësuar gabimin dhe tani është pronë komunale, detajet tjera rreth këtij propozim vendimi besoj se i keni analizuar në materialin e dërguar, bëhet fjalë për dhënie në shfrytëzim për raste të veçanta, andaj kërkoj edhe të mbështetet nga ky Kuvend.

Pas votimit u konstatua se me 26 vota për, 8 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

8. Informata e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për punët dhe aktivitetet e KKSB-së për vitin 2017

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, dhe Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, meqë është obligative të sjellët një informata e tillë në Kuvendin e Komunës, ne kemi sjellë këtë. Qëllimi i kësaj informate është njoftimi për punët dhe aktivitetet e KKSB-së në vitin 2017, përndryshe ne mund të debatojmë rreth kësaj, mirëpo nuk mund të ndryshojmë asgjë sepse janë çështje të cilat kanë ndodhë në vitin paraprak.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, sa i përket mbështetjes ose jo të kësaj informate, unë e hedh në votim edhe pse nuk është e paraparë që informata të tilla t'i nënshtrohen procesit të votimit.

Pas votimit njëzëri u mbështet Informata në fjalë

9. Të ndryshme

z.Blerim Maqastena, fillimisht tha se në mbledhjen e kaluar, në pikën të ndryshme kam bërë dy pyetje Drejtorëve të Drejtorive përkatëse, rreth shkollës së fshatit Dumosh dhe ambulancës së këtij fshati, por që nuk kam marrë përgjigje.

Paraqiti pyetjet, si në vijim; 1- për drejtorin për investime kapitale, stadiumi i KF "Llapi" i paraparë të ndërtohet në fshatin Dumosh, a do të fillojë në këtë vit dhe kur do të fillojë, 2- për drejtorin për shërbime publike, a do të fillojë pastrimi i lumit Dumnica.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ju falënderoj të gjithëve për kontributet e juaja, jeni në dijeni se në muajin që po hyjmë kemi të paraparë pushim përveç ndonjë rasti eventual që mund të jetë i jashtëzakonshëm, pra muaji gusht është pushim dhe ju dëshiroj të kaloni sa më mirë të jetë e mundur.

Gjithashtu dëshiroj t'ju njoftoj se raporti për funksionimin e Kuvendeve të Komunave të Kosovës është sjellë dhe kam vërejtur se Komuna e Podujevës qëndron mjaftë mirë në këtë aspekt, pra vlerësimi për Kuvendin e Komunës së Podujevës është mjaftë pozitiv.

z.Agim Behluli, theksoi, dëshiroj t'ju informoj rreth punës së komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc. Mund të them se ata banorë dhe ato familje janë në mjerim. Ne jemi mundur të japim dhe të bëjmë më të mirën, sa kemi arrit mund të vlerësohet në të ardhmen. Përveç të tjerave ata banorë përballen edhe me një fenomen tjetër, ku pjesa më e madhe e tyre madje nuk janë as të kënaqur edhe me ndarjen e shtëpive. nuk di se çfarë kanë bërë komisioni paraprak, por ne tani jemi marrë shumë me këtë Lagje dhe ata banorë si dhe jemi munduar të japim më të mirën, dhe shumë shpejt do të dalin edhe rezultatet e përfituesve të shtëpive që janë ndërtuar tash së fundmi. Sërish bëjë thirrje tek të gjithë këshilltarët e Kuvendit që të përdorim të gjitha mundësitë tona qoftë në aspektin e kompetencave qoftë partiake në raport me nivelin qendrorë qoftë aspekte tjera në mënyrë që sa më shpejt të jetë mundur të ndërtohen edhe shtëpitë tjera dhe të largohen ato familje nga ata kontejner.

z.Florent Hasani, theksoi, kërkoj që në magjistralen Podujevë – Prishtinë, përkatësisht në afërsi të Hotel "Besiana" ku dikur ka qenë "punkti i sabraqajve kriminel serb" ku së fundmi ka filluar edhe ndërtimi i rreth rrotullimit, kërkoj të ndërtohet një shqiponjë metalike (me përmasa të asaj që është në hyrje të Tiranës) si një mesazh për fqinjët dhe të tjerët që vijnë në Kosovë, se po futen në tokë Shqiptare.

z.Vendenis Lahu, theksoi, si anëtarë i komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, e përkrahi atë që parafolësi z.Agim Behluli e ceku. Është gjendje e vërtetë ajo që u tha, andaj kërkoj edhe nga ju që të dalim dhe të vizitojmë atë Lagje si dhe sa më shpejt dhe sa më shumë të punojmë që të ndërtohet ajo Lagje në tërësi sepse pakënaqësitë e atyre banorëve janë të mëdha dhe situata e tyre është mjaftë e vështirë. Andaj përfundimi i asaj Lagjeje me shtëpi të reja për të gjitha familjet do të ishte e mirë për ne si Kuvend, qeverisjen e kësaj Komune dhe për shoqërinë në përgjithësi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, z.Agim Behluli na njoftoj për gjendjen në Lagjen e Dëshmorëve e që besoj se shumica prej nesh jemi në dijeni për gjendjen dhe situatën e asaj Lagjeje. Unë vetëm deshta të potencoj se sa jam i njoftuar deri tani janë ndërtuar 53 shtëpi, 20 ndahen në këtë fazë, ku gjithsejtë bëhen 73, që të gjitha të ndërtuara nga niveli qendror, kurse të gjitha çështjet tjera infrastrukturore dhe urbanistike janë investime nga niveli lokal. Sa jam në dijeni kanë qenë të planifikuara që në këtë vit të fillojnë të ndërtohen edhe 20 shtëpi tjera, dhe në këtë aspekt sa i përket mbështetjes përmes subjekteve politike, sa ka qenë zëvendësministri i PDK-së në Ministrinë përkatëse, ne e kemi iniciuar dhe kemi marrë mbështetje ku është ndarë buxhet prej rreth 200,000.00 € nga niveli qendrorë, dhe për këtë është edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës z.Fidan Rekaliu, mirëpo ende nuk ka filluar ndërtimi i atyre shtëpive. Pastaj mbeten edhe 26 shtëpi të ndërtohen në mënyrë që të përfundoj projekti në tërësi së bashku me ato 20 që duhet të fillojnë, pra janë edhe 46 shtëpi që duhet të ndërtohen. Në mandatin e kaluar Kuvendi komunal i Podujevës e ka pas një buxhet të ndarë për ndërtimin e shtëpive sociale, buxhet i cili është heq me vendim të Kryetarit të Komunës. Meqë propozimi ose kërkesa vie nga këshilltari në fjalë që është nga radhët e LDK-së, kërkesë e cila është me një qëllim të mirë, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së që tani e mbështetë që me rishikim të buxhetit të ndahen mjetet për ndërtimin e 10 shtëpive në atë Lagje, ky është edhe propozim i imi. Sa kam informata kostoja e një shtëpie është rreth 17,000.00 €, nuk është shumë madhe 170,000.00 € për ndërtimin e 10 shtëpive, e që mendoj se vetëm inkasimi i të hyrave nga borxhlinjtë e Komunës që 17 vite, do të ndërtoheshin 10 shtëpi.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, duke parë tendencën e një meritokracie, e them me përgjegjësi shumë të madhe se ndarja e buxhetit për ndërtimin e 20 shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve është bërë pikërisht në mandatin e Ministrit të MPMS z.Arban Abrashi si dhe është marrë vendimi edhe për ndërtimin e 20 shtëpive tjera. pra kjo është vetëm sa për sqarim sepse e vërejta tendencën për merita të tjerëve.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, kërkoj falje, por dëshiroj të paraqes një kërkesë për korrigjim, e cila është paraqitur nga kompania e cila e ka bërë projektin e kanalizimit në fshatin Orllan, projekt për të cilin këshilltarët e mandatit të kaluar janë në dijeni. Fjala është për dy parcela të ndara në fshatin Orllan për ndërtimin e impiantit dhe kanalizimit të ujërave të zeza, mirëpo gjatë realizimit të projektit kemi hasë në një pengesë nga ana e qytetarëve dhe ka qenë dëmtimi i një kroi, duke marrë parasysh se edhe nuk kanë ujësjellës, kemi parë të arsyeshme që ta ndërrojmë parcelën, sërish të japim një parcelë tjetër diku rreth 300 - 500 m larg atij burimi natyror – kroi, andaj për t’iu dhënë leja ndërtimore kompanisë që ka filluar punimet, ne kërkojmë të kalojmë nga parcela 1617-0 në parcelën 1615-1, e cila do t’i jepet me gjithë rrugë dhe me aksesoret tjerë në sipërfaqe prej rreth 4 ari ose 4000 m² për ndërtimin e impiantit në fjalë. Pra kjo është kërkesë e kompanisë, andaj meqë vendimi ka qenë i Kuvendit të Komunës, kërkoj të mbështetët korrigjimi i cekur, kalimi nga një parcelë në tjetrën, në mënyrë që të pajiset me leje ndërtimore. Kërkoj falje që krejt në fund mora fjalën dhe e paraqita këtë kërkesë, por nuk e kam pasë sipërfaqen përkatëse dhe tek sot e mora.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, do të thotë kemi edhe një kërkesë për korrigjim të një vendimi të Kuvendit.

z.Bajram Ajeti, theksoi, konsideroj se çështjet kaq të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me pronën, në këtë rast me 40 ari, në pikën të ndryshme drejtori parafolës kërkon t’ia miratojmë me arsyetim se sot kam marrë kërkesën, kjo nuk është seriozitet. Mendoj se është dashtë të futet në rend të ditës ashtu sikurse që patëm edhe çështje tjera të cilat fillimisht janë përfshirë në rend të ditës pastaj diskutohet, shqyrtohet dhe del në votim, andaj të mbetet për mbledhjen e radhës sepse nuk mund ta kalojmë në këtë formë.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, edhe njëherë kërkoj falje, por unë dje kamë kërkuar nga kompania e cila ka bërë projektin, ata sot në mëngjes kanë dal dhe kanë cekë sipërfaqen e parcelës të cilën e kemi dhënë në vitin 2016 për realizimin e projektit, kurse tani ka filluar realizimi i atij projekti, andaj asgjë të keqe nuk ka rreth kësaj çështje sepse ashtu siç e kemi dhënë në atë kohë, tani vetëm po e ruajmë një burim ujorë duke marrë parasysh se Orllani nuk ka ujësjellës, por edhe në bazë të ankesave të banorëve se po dëmtohet ai burim ujorë, ne e kemi parë të arsyeshme të largohemi me një distancë prej 300 deri 500 metra nga ai burim. Pra e tëra është pronë komunale dhe vetëm kërkohet korrigjimi i vendimit përkatës i Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuar drejtor, proceduralisht jeni gabim, as në mbledhjen e KPF-së, as në fillim të kësaj seance nuk e keni paraqitur, kurse tani në përfundim të kësaj mbledhje në pikën të ndryshme ku nuk ka votim, ju e paraqitni një kërkesë të tillë. Pra i humbet kuptimi kësaj seance, por edhe punëkryesi duhet të dispijlohet, nëse të është sjellë kërkesa sot para kësaj seance është dashur ta futni si pikë në fillim të kësaj mbledhje, nëse e ka sjellë tani është dashtë t’i thoni se nuk kemi procedurë, pra edhe neve si Kuvend po na vështirësohet puna sepse nuk jemi ta pengojmë punën por nuk jemi as që ta dëmtojmë një burim që është pasuri nacionale. Ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së asnjëherë nuk kemi dalë kundër investimeve dhe nuk kemi paraqitur pengesa sepse janë edhe kërkesa të qytetarëve. Unë i kuptoj të gjitha vështirësitë e juaja si Drejtor i DPKGJ sepse janë bërë edhe ndryshime në pika dhe gjëra të tjera, por shpesh po ndodh të ketë ndryshime – korrigjime të tilla sepse pastaj pronat po dalin të jenë ose private ose shoqërore apo ku ta dijë unë. Pra duhet ta

lëmë këtë çështje për tjetrën seancë sepse proceduralisht nuk mendoj se jemi në rregull, madje nuk po shoh as disponim as edhe nga anëtarët e Kuvendit për këtë çështje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se duhet të respektohen procedurat, andaj mendoj se kërkesa e tillë është mirë të sjellët në seancën e radhës, të diskutojmë dhe të marrim vendim për një gjë të tillë.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marr fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:25

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0060943/18
Podujevë,
31 korrik 2018**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**